# FLETORJA ZYRTARE
# E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare**
**www.legjislacioni.gov.al**

| **Nr. 69** | **Datë 16 maj 2014** |
|---|---|

P Ë R M B A J T J A

| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i KM nr. 119, datë 5.3.2014 | Për miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Kufirit e të planit të veprimit, 2014 – 2020............................ | 2527 |

**VENDIM**
**Nr. 119, datë 5.3.2014**

**PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE TË MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË KUFIRIT E TË PLANIT TË VEPRIMIT, 2014 - 2020**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Kufirit e të planit të veprimit, 2014 - 2020, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Financave, Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Integrimit Evropian, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Ministria e Mjedisit, Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Kulturës, Ministria e Energjisë dhe Industrisë dhe Shërbimi Informativ i Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**STRATEGJIA KOMBËTARE**
PËR MENAXHIMIN E INTEGRUAR TË KUFIRIT
DHE PLAN-VEPRIMI
Strategji ndërsektoriale
(2014-2020)

Përgatitur nga:
Ministria e Punëve të Brendshme(MPB) – Policia e Shtetit Shqiptar (PSHSH) / Policia Kufitare dhe Migracionit (PKM)
Ministria e Financave (MF) - Shërbimi Doganor Shqiptar (SHDSH)
Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU) – Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU)
Ministria e Shëndetësisë (MSH) – Shërbimi Veterinar Antiepidemik (SHSA)
Ministria e Mbrojtjes (MM) –Roja Bregdetare (RB)
Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ) – Shërbimi Konsullor (SHKSH)
Ministria e Integrimit Europian (MIE)
Ministria e Drejtësisë (MD)
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes (MZHETS)
Ministria e Energjisë dhe Industrisë (MEI)
Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit (MZHUT)
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës (MTI)
Ministria e Arsimit dhe Sportit (MAS)
Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë (MMSR)
Ministria e Kulturës (MK)
Ministria e Mjedisit (MeM)
Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD)
Partnerët ndërkombëtarë
PAMECA
ICITAP
OSBE
IOM
ICPD

HYRJE

KONCEPTI I MENAXHIMIT TË INTEGRUAR TË KUFIRIT (MIK) NË SHQIPËRI

Koncepti i menaxhimit të integruar të kufirit u aplikua në Shqipëri plotësisht pas miratimit të Strategjisë së Menaxhimit të Integruar të Kufirit dhe Planit të saj të Veprimit 2007-2013. Në këtë strategji u parashikuan të gjitha masat që do të realizoheshin nga të gjitha agjencitë e përfshira direkt dhe indirekt në kufi.

*"Menaxhimi i integruar i kufirit" është bashkërendimi dhe bashkëpunimi ndërmjet të gjitha autoriteteve dhe agjencive, të përfshira në sigurinë kufitare dhe lehtësimin e tregtisë, me qëllim përsosjen e sistemeve të efektshme dhe me rendiment të menaxhimit të integruar të kufirit, me synimin e arritjes së qëllimit të përbashkët të kufijve të hapur, por të kontrolluar dhe të sigurt.*

Puna e bërë duke u bazuar në zbatimin e objektivave dhe veprimeve të parashikuara në planin e veprimit, forcoi bashkëpunimin në tri shtyllat ku mbështetej kjo strategji. Shqipëria zbatoi në praktikë menaxhimin e efektshëm të kufirit nga të katër agjencitë e përfshira direkt në këtë fushë, si PKM, SHDSH, SHF dhe SHV.

Në agjencitë kryesore u aplikuan format e reja të kontrollit dhe të mbikëqyrjes së kufirit, duke u shoqëruar me ndryshime në fushën ligjore, në menaxhim dhe organizim, në procedura, në burimet njerëzore dhe trajnimin e tyre, në përsosjen e teknologjisë së informacionit dhe rritjen e shkallës së komunikimit brenda agjencive, ndërmjet agjencive dhe ndërkombëtar, si dhe në përmirësimin e infrastrukturës dhe kompletimit me pajisje të agjencive të kufirit në interes të realizimit të detyrave ligjore për kontrollin e mbikëqyrjen e kufirit.

Qëllimi tërësor i strategjisë MIK

Me strategjinë e MIK dhe planin e saj të veprimit, të miratuar në vitin 2007 dhe të përditësuar në vitin 2009, u përcaktuan rrugët për të bërë një ndarje të qartë të

detyrave dhe të përgjegjësive, si dhe për forcimin e bashkëpunimit në shkëmbimit efikas të informacionit. Ky bashkëpunim dhe bashkërendim nuk u kufizua vetëm në sektorët brenda agjencive të përfshira direkt në MIK, por u shtri edhe në agjenci e struktura të përfshira në menaxhimin kufitar brenda Shqipërisë dhe në nivel ndërkombëtar.

Strategjia për menaxhimin e integruar të kufirit është një dokument strategjik në përmbushje të objektivave madhore të Qeverisë për arritjen e standardeve në kuadër të integrimit dhe anëtarësimit të Shqipërisë në BE. Objektivat e përcaktuara në këtë dokument strategjik shkojnë në një linjë me detyrimet që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit dhe rekomandimet e BE-së për Shqipërinë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Europian.

Përvoja e fituar dhe rezultatet e arritura nga zbatimi i Strategjisë dhe planit të veprimit të MIK, përbëjnë garanci për zbatimin e objektivave të përcaktuara në strategjinë e MIK 2014-2020.

KAPITULLI 1
KUSHTET AKTUALE

**Menaxhimi i integruar i kufirit në Shqipëri**

Në fushën e menaxhimit të integruar të kufirit Shqipëria ka realizuar progres të vazhdueshëm në të gjithë komponentët përbërës të MIK, si: në fushën e përmirësimit të kuadrit ligjor, të organizimit dhe të menaxhimit të agjencive kufitare, të rritjes së kapaciteteve administrative dhe profesionale të strukturave, të zbatimit të procedurave standarde të punës, të zbatimit të programeve të trajnimit dhe të kurrikulave, të përmirësimit të infrastrukturës dhe teknologjisë së informacionit, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj qytetareve, lehtësimit të shkëmbimeve tregtare dhe në drejtim të forcimit të goditjes ndaj aktivitetit të paligjshëm nëpërmjet kufirit shtetëror dhe rritjes së sigurisë kufitare.

Gjatë viteve 2008-2012 u punua:

Në drejtim të kuadrit ligjor rregullator, janë hartuar disa akte ligjore, si: ligji nr. 9861, datë 24.1.2008, "Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit"; ligji nr. 108/2013 "Për të huajt"; përmirësime të dispozitave zbatuese të Kodit Doganor; ligji nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin"; ligji nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar"; ligji nr. 10433, datë 16.6.2011, "Për inspektimin"; ligji nr. 9362, datë 24.3.2005, "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve"; ligji nr. 10390, datë 3.3.2011, "Për plehrat e përdorimit për bimësinë", ligji nr. 10416, datë 7.4.2011 "Për materialin mbjellës e shumëzues bimor", ligje dhe akte nënligjore që kanë dalë në zbatim të këtyre ligjeve. Këto akte ligjore dhe nënligjore janë hartuar bazuar në rekomandimet e BE-së, standardet Schengen dhe praktikat e mira kanë qenë të parashikuara në "Strategjinë për menaxhimin e integruar të kufirit 2008-2013". Ministria e Shëndetësisë, pjesë e së cilës është Shërbimi Sanitar Antiepidemik, e bazon punën në ligjin nr. 10138, datë 11.5.2009, "Për shëndetin publik". Në kuadrin e menaxhimit të faunës dhe florës së egër aktivitetet bazohen në ligjin nr. 9867, datë 31.1.2008, "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave për tregtimin ndërkombëtar të llojeve të rrezikuara të faunës dhe të florës së egër". Gjithashtu nga agjencitë e MIK janë miratuar akte administrative për bashkëpunim të ndërmjet agjencive, agjencitë homologe të vendeve fqinje dhe më gjerë.

Në drejtim të menaxhimit dhe organizimit (kuadri institucional), u ngrit struktura e Policisë Kufitare dhe Migracionit, një strukturë sipas rekomandimeve dhe e bazuar në objektivat e Strategjisë. U krijuan Analiza e Riskut dhe Sektori i Hetimit. Kjo strukturë nuk u pa si statike, por ka ardhur duke u ndryshuar dhe përmirësuar. Për këtë vlen të përmendet shtrirja e shërbimit të Analizës së Riskut dhe të Hetimit në të gjitha drejtoritë rajonale. Përmirësime strukturore u bënë dhe në Shërbimin Doganor Shqiptar, u krijuan strukturat e luftës kundër trafikut dhe korrupsionit dhe u fuqizuan ato të teknologjisë së informacionit. Gjithashtu me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1081, datë 21.10.2009, "Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Ushqimit", si dhe me urdhrin e ministrit të MBUMK-së nr. 262 datë 25.8.2010 "Për fillimin e veprimtarisë së Autoritetit Kombëtar të Ushqimit në fushën e kontrollit të ushqimit dhe ushqimit për kafshë dhe kompetencat e plota janë marrë me urdhrin e ministrit të MBUMK nr. 229, datë 15.7.2011, u krijua Autoriteti Kombëtar i Ushqimit. Shtrirja e këtij shërbimi në pikat e kalimit kufitar është miratuar me urdhrin e MBUMK-së nr. 6, datë 25.1.2011, "Mbi miratimin e pikave të kontrollit kufitar ku kryhet inspektimi veterinar, fitosanitar dhe i ushqimit për njerëz dhe kafshë në Republikën e Shqipërisë". Është e nevojshme të vlerësohet integrimi i Shërbimit Sanitar Antiepidemik shërbimi si pjesë përbërëse e MIK. Me kërkesën e BE-së dhe vullnetin e Shqipërisë, për zgjidhjen e çështjes së kontrollit civil mbi operacionet detare dhe harmonizimin e marrëdhënieve midis institucioneve që kanë përgjegjësi dhe interesa në det, u krijua Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD).

Në fushën e procedurave. Gjatë kësaj periudhe u zhvilluan dhe u përmirësuan procedurat standarde të punës nga agjencitë e përfshira në MIK, si Procedurat Standarde të Punës, bazuar në Manualin Schengen për PKM, procedura që janë përmirësuar dhe përditësuar me ndryshimet e Kodit Schengen. Në këtë stad, Policia Kufitare dhe Migracionit, veprimtarinë në të gjithë piramidën e saj, e bazon në këto procedura. U

përmirësuan procedurat doganore për të lehtësuar shkëmbimet tregtare dhe marrjen nga ky shërbim të përgjegjësive në fushën e sigurisë kufitare. Për QNOD-në janë miratuar "Politikat dhe procedurat e funksionimit të Qendrës Ndërinstitucionale Operacionale Detare". U hartuan procedura edhe nga shërbimet e tjera kryesore në Strategji. Shqipëria është i pari vend në rajon që aplikoi kontrollin me një ndalesë në të gjitha PKK-të. Procedurat e AKU-së janë miratuar, por bazuar në kuadrin e plotë ligjor, janë në proces hartimi i procedurat standarde të punës për inspektimin e ushqimit.

Në fushën e burimeve njerëzore dhe trajnimit. Lidhur me këtë fushë në Strategjinë aktuale u parashikuan veprime që kanë të bëjnë me rekrutimin dhe përzgjedhjen e personelit të agjencive që operojnë në kufi, bazuar në standardet e BE-së. Nga agjencitë e kufirit bëhet menaxhimi i burimeve njerëzore, ndiqet ecuria në karrierë. Për vendet e punës bëhet përzgjedhja e personelit bazuar në kritere të mirëpërcaktuara dhe të miratuara. Gjithashtu bazuar në strategjinë e MIK, janë krijuar mekanizma trajnimi të cilat ndjekin ecurinë e trajnimeve të personelit të agjencive të kufirit. Për PKM ky aktivitet zhvillohet në bazë të "Strategjisë së trajnimeve 2011-2016". Në kuadër të bashkëpunimit janë realizuar trajnime me strukturat e tjera të policisë, me SHDSH dhe trajnime mes agjencive ndërkufitare. Në AKU po punohet për të hartuar një program për trajnimin e inspektorëve të PIK mbështetura nga BE.

Në fushën e komunikimit, shkëmbimit dhe teknologjisë së informacionit. Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit u zhvillua në mënyrë të shpejtë në këtë periudhë. Vlen të përmendet informatizimi i të gjitha shërbimeve të kufirit dhe pajisja e tyre me mjete komunikimi. U miratuan akte administrative të brendshme dhe të përbashkëta. Gjithashtu janë përgatitur manuale përdorimi dhe procedura që lehtësojnë shkëmbimin e informacionit. Të gjitha PKK-të e Republikës së Shqipërisë janë të lidhura *on-line* me sistemin TIMS, një sistem ku policia kufitare evidenton hyrje/daljet në kufirin shtetëror dhe të gjithë problematikën që lind në kufi. Teknologjia e informacionit u përmirësua dhe u shtri në të gjitha degët doganore të SHDSH, duke mundësuar aplikimin 100% të deklaratave doganore në sistemin ASYCUDA WORLD, gjë e cila ndikon në rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj bizneseve. Për AKU është bërë shtrirja e linjës intranet, në të gjitha PIK, por jo në efikasitetin e duhur.

Në fushën e infrastrukturës dhe pajisjeve. Agjencitë e kufirit kanë infrastrukturën e duhur për realizimin e misionit të tyre. Me financim të BE-së dhe Qeverisë Shqiptare, janë rikonstruktuar dhe ndërtuar ambiente bashkëkohore pune (10 PKK, një PPKK me Malin e ZI, një PKK me Greqinë në Qafë Botë, 17 stacione të PKM, dy komisariate të PKM dhe godina e Njësisë Territoriale të Lëvizshme të PKM). Gjithashtu shërbimet kufitare kanë përmirësuar në vijimësi inventarin e pajisjeve të kontrollit dhe të survejimit të kufirit, disa prej të cilave janë futur për herë të parë në këtë shërbim. Këtu mund të përmenden si vijon: pajisje për kontrollin e dokumenteve; të mjeteve të transportit gjatë kontrolleve në vijën e parë dhe të dytë; pajisje të vëzhgimit ditën dhe natën; sistemin SMARTDEC i cili është vendosur në drejtimet me risk të kufirit shtetëror dhe sistemi i monitorimit me kamera në PKK. Përsa i përket monitorimit të hapësirës detare është realizuar përmirësimi i infrastrukturës së QNOD duke marrë akses në sistemet LOCKED MARTIN, TETRA dhe BLU BOX. AKU është e shtrirë në PKK kryesore dhe ka ambiente dhe pajisje pune, por jo në nivelin e duhur për të realizuar misionin e tyre.

Është rritur bashkëpunimi ndërinstitucional në luftën kundër korrupsionit. Mekanizmi i ngritur për të monitoruar aktivitetin e agjencive kufitare: strukturat antikorrupsion në agjencitë e kufirit, vendosja e kamerave në PKK, zbatimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit në kryerjen e procedurave kufitare, eliminimi i taksës së hyrjes së automjeteve në Shqipëri dhe një sërë masash të tjera ka bërë që të arrihet progres në këtë fushë.

Lufta kundër terrorizmit është dhe mbetet një nga prioritet kryesore të Qeverisë Shqiptare. Agjencitë kufitare e kanë parë veten pjesë të kësaj lufte dhe për këtë janë trajnuar dhe janë pajisur me mjete për zbulimin e lëndëve radioaktive dhe kanë akses në listat e personave që dyshohen së mbështesin terrorizmin ndërkombëtar të evidentuara në sistemin TIMS dhe ASF2.

Është forcuar bashkëpunimi ndërinstitucional nëpërmjet miratimit dhe zbatimit të një sërë aktesh nënligjore, si: rregullore për bashkëpunimin ndërmjet Policisë së Shtetit, Shërbimit Doganor, Shërbimit Veterinar dhe Shërbimit Fitosanitar.

Është përmirësuar koordinimi i punës midis strukturave të zbatimit të ligjit dhe agjencive të tjera partnere dhe OJF-ve të përfshira në luftën kundër trafikimit të personave dhe mbrojtjen e viktimave të trafikimit. Policia Kufitare dhe e Migracionit mori detyrimet e veta dhe po i zbaton në lidhje me identifikimin e viktimave të trafikimit dhe evidenton në vazhdimësi viktimat e mundshme të trafikimit në databazën përkatëse. Gjithashtu, është punuar për përmirësimin e funksionimit të Mekanizmit Kombëtar të Referimit për Viktimat, duke identifikuar viktima të mundshme potenciale gjatë intervistimit në kufi.

Bashkëpunimi ndërkombëtar dy e shumëpalësh ka qenë rezultativ. Shqipëria ka nënshkruar dhe po zbaton Marrëveshjen e bashkëpunimit policor të vendeve të Evropës Juglindore (2005), marrëveshje me vendet fqinje, si: "Për bashkëpunimin Policor", "Për patrullimet e përbashkëta në kufirin shtetëror" dhe "Për

takimet e PKM në tre nivelet", "Për hapjen e PKK të përbashkëta", "Për procedura të përbashkëta kontrolli", si dhe marrëveshje dy apo shumëpalëshe për bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare. Po në kuadër të bashkëpunimit ndërkombëtar Shqipëria është një pjesëmarrëse aktive në aktivitetet e FRONTEX. Përfaqësues të saj kanë marrë pjesë si vëzhgues në një sërë operacionesh që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen e kufijve të gjelbër dhe kontrollin në aeroporte.

Detyrimet e përcaktuara në rregulloret Schengen (2006 dhe 2009) janë identifikuar dhe aplikuar në mënyrë progresive nga agjencitë e kufirit në Shqipëri.

Sfidat për menaxhimin e integruar të kufirit në Shqipëri

Komisioni Evropian ka vlerësuar në vazhdimësi përparimin e bërë në lidhje me menaxhimin e integruar të kufirit, por sfidat për MIK në Shqipëri kërkojnë përmirësime të mëtejshme brenda agjencive të kufirit, si dhe në bashkëpunimin ndëragjenci e ndërkombëtar. Më konkretisht do të përmendim sa më poshtë:

- Përmirësime të mëtejshme të kuadrit ligjor rregullator, të strukturave të agjencive kufitare, të procedurave të punës, të burimeve njerëzore dhe trajnimeve, të shkëmbimit të informacionit dhe të infrastrukturës dhe pajisjeve;
- Përmirësimin e bashkëpunimit ndëragjenci në funksion të rritjes së cilësisë dhe shpejtësisë së shkëmbimin e informacionit, procedurave për kontrolle të përbashkëta, analizës së përbashkët të riskut për komponentë të caktuar në kontrollin kufitar, në përdorimin e përbashkët të infrastrukturës kufitare dhe pajisjeve, si dhe në zhvillimin e mëtejshëm të programeve të përbashkëta të trajnimit për personelin e agjencive kufitare;
- Përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit ndërkombëtar, për të zbatuar një zinxhir masash në luftën e autoriteteve kufitare kundër aktivitetit të kundërligjshëm nëpërmjet kufirit përfshire dhe terrorizmin.

Realizimi i këtyre përmirësimeve do të sjellë arritjen e misionit të kësaj Strategjie për përafrimin e plotë në praktikë me standardet e kontrollit dhe të mbikëqyrjes së kufirit të Rregullores Schengen dhe të vendeve anëtare të BE-së.

## KAPITULLI 2
## VIZIONI, POLITIKAT DHE QËLLIMET STRATEGJIKE

Vizioni

Shqipëria të ketë një menaxhim të integruar të kufirit në harmoni të plotë me standardet e BE-së.

Ky vizion është i lidhur ngushtë me rritjen e përgjegjësive të çdo institucioni të përfshirë në menaxhimin e integruar të kufirit, në ndërtimin dhe përsosjen e infrastrukturës së plotë ligjore, plotësisht sipas standardeve të BE-së, rritjen e kapaciteteve e aftësive tekniko-profesionale dhe operacionale, zbatimin cilësor të masave e detyrave të parashikuara në planet e veprimit të strategjive të tjera të lidhura me MIK, në rritjen e bashkëpunimit ndërinstitucional dhe ndërkombëtar dhe implementimin sipas fazave të kësaj strategjie.

Politikat dhe qëllimet strategjike

Strategjia synon të zhvillojë politikat e duhura për të përmirësuar më tej standardet e sigurisë kufitare, nëpërmjet rritjes së efikasitetit në menaxhimit burimeve njerëzore dhe teknike; rritjes së kapaciteteve operacionale për parandalimin dhe goditjen e krimit ndërkufitar bazuar në vlerësimin e kërcënimeve; rritjes së bashkëpunimit me strukturat e brendshme dhe partnerët fqinjë dhe të BE-së; rritjes së kapaciteteve investiguese dhe orientimit të këtyre strukturave drejt inteligjencës; rritjes së menaxhimit e përpunimit të informacionit kriminal (duke përdorur sistemin MEMEX); rritjes dhe përmirësimit të kapaciteteve për aplikimin e teknologjive të reja në fushën e menaxhimit të kufirit të gjelbër dhe blu dhe aplikimi i masave plotësuese për kontrollin në territor me qëllim kontrollin e territorit në lidhje me emigracionin e paligjshëm.

Qëllimi i përgjithshëm strategjik i Qeverisë Shqiptare për menaxhimin e integruar të kufijve, është përsosja e sistemit të sigurisë kufitare, duke arritur përafrimin e plotë me atë të vendeve anëtare të BE-së.

Qëllimi specifik i Strategjisë MIK është konsolidimi i arritjeve në fushën e menaxhimit të kufirit për përmirësimin e sigurisë së kufirit, lehtësimin e lëvizjes së shtetasve dhe shkëmbimeve tregtare, në mënyrë që të garantohen kufij të hapur dhe të sigurt në funksion të përmirësimit të cilësisë së jetës së qytetarëve.

Komponentët e Strategjisë së menaxhimit të integruar të kufirit

Kjo Strategji do të synojë forcimin e bashkëpunimit sipas standardeve të BE-së dhe praktikave të mira në menaxhimin e integruar të kufirit, në katër komponentët që e përbejnë atë:

1. Bashkëpunimi brenda agjencisë;
2. Bashkëpunimi midis agjencive;
3. Bashkëpunimi ndërkombëtar;
4. Masat plotësuese për kontrollin në territor.

Për realizimin e tyre do të fokusohemi në këto fusha: në kuadrin ligjor dhe rregullator; në kuadrin institucional; në procedurat; në burimet njerëzore dhe trajnimet; në komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit dhe në infrastrukturën dhe pajisjet.

Qëllimet strategjike të bashkëpunimit brenda agjencisë për Policinë Kufitare dhe Migracionit

1. Kuadri ligjor rregullator. Do të përcaktohen me aktet ligjore dhe nënligjore aplikimi i rregullave Schengen për kufijtë dhe për masat plotësuese për kontrollin në territor.

Aktualisht PKM aplikon disa aktivitete që janë të përafërta me masat plotësuese për kontrollin në territor. Zbatimi në praktikë i këtyre masave do të bëhet me ndryshimet përkatëse në kuadrin ligjor.

2. Kuadri institucional. Do të përshtatet me strukturat e vendeve të BE-së dhe do të krijohen/konsolidohen ato të zbatimit të masave plotësuese për kontrollin në territor, sipas shembullit të Grupeve të Lëvizshme Operacionale.

3. Procedurat. Do të unifikohet zbatimi i tyre, aplikimi i procedurave shtesë që kanë të bëjnë me sigurinë kufitare, sidomos me masat plotësuese për kontrollin në territor dhe me ndryshimet e mundshme në rregulloret Schengen për kufijtë e jashtëm.

4. Burimet njerëzore dhe trajnimi. Do të vazhdohet trajnimi sipas kurrikulave bazuar në modelin e FRONTEX dhe trajnimi i vazhdueshëm për përdorimin e pajisjeve në dispozicion të PKM, sidomos ato që kanë të bëjnë me kontrollin e linjës së dytë dhe ato të mbikëqyrjes së kufirit.

5. Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe IT. Do të përmirësohet sistemi TIMS në të gjithë shërbimet e policisë kufitare. Një rëndësi e veçantë do t'i jepet kompletimit të grupeve të lëvizshme me mjete, pajisje kontrolli dhe elektronike për të bërë verifikimin në kohë reale dhe ekzaminimin e dokumenteve të udhëtimit të shtetasve të huaj që gjenden në territor, duke iu referuar Regjistrin Elektronik të Shtetasve të Huaj (FER = Foreigners Elektronik Register). Do të synohet konsultimi me SHDSH, për të dhënat e automjeteve të importuara pa drejtues. Do të synohet konsultimi me sistemin SIS të vendeve Schengen, për të dhënat e shtetasve shqiptarë.

6. Infrastruktura dhe pajisjet. Do të synohet në shtimin e pajisjeve në bazë të teknologjive e reja dhe marrjen e masave për mirëmbajtjen e tyre.

Qëllimet strategjike të bashkëpunimit brenda agjencisë për Shërbimin Doganor Shqiptar:

1. Kuadri ligjor rregullator. Do të hartohet dhe miratohet Kodi i ri Doganor, në referencë të plotë me Kodin Doganor të BE-së (kodi i ri i modernizuar i BE-së) dhe dispozitat e tij zbatuese.

2. Kuadri institucional. Zhvillimi i kuadrit institucional do të vijojë të realizohet në përputhje me praktikat e mira të vendeve anëtare të BE-së.

3. Procedurat. Do të përmirësohen në vijimësi në funksion të lehtësimit të tregtisë së ligjshme dhe lëvizjes së shtetasve, duke garantuar kontrolle efektive dhe efikase kufitare.

4. Burimet njerëzore dhe trajnimi. Do të përmirësohen më tej, me qëllim arritjen e standardeve të vendeve anëtare të BE-së, duke qenë në vëmendje profesionalizmi dhe integriteti i punonjësit doganor.

5. Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe IT. Do të përmirësohet niveli ekzistues i informatizimit të procedurave doganore dhe zbatimi në praktikë i sistemeve informatike në linjë me ato që përdoren nga doganat e vendeve të BE-së, si dhe mundësimi i aksesimit reciprok në sistemet e agjencive të tjera me funksione kontrolli në kufi.

6. Infrastruktura dhe pajisjet. Do të përmirësohet infrastruktura dhe pajisjet në përdorim të SHDSH, do të synohet në shtimin e numrit dhe cilësisë së pajisjeve të kontrollit kufitar, shoqëruar me paketat e nevojshme të trajnimit dhe garantimit të qëndrueshmërisë së nivelit të tyre përmes sigurimit të financimeve të nevojshme.

Qëllimet strategjike të bashkëpunimit brenda agjencisë për Autoritetin Kombëtar i Ushqimit:

1. Kuadri ligjor rregullator. Do të synohet në përafrimin e plotë të legjislacionit kombëtar, të fushave që mbulohen, me legjislacionin e vendeve të BE-së.

2. Kuadri institucional. Do të synohet që ndryshimet e mundshme strukturore do të shoqërohen me konsultime me agjencitë e kufirit dhe ato të vendeve fqinje për të lehtësuar shkëmbimin e informacionit.

3. Procedurat. Do synohet zhvillimi procedurave të njëjta me vendet e BE-së.

4. Burimet njerëzore dhe trajnimi. Do të synohet që personeli i cili operon në PIK, të përzgjidhet me kritere të përcaktuara qartë, me profesionalizëm dhe i mirë trajnuar.

5. Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe IT. Do të synohet në perfeksionimin e rrugëve të shkëmbimit të informacionit, me qëllim që ky shkëmbim të jetë i njëjtë me vendet e BE-së.

6. Infrastruktura dhe pajisjet. Do të synohet në përmirësimin e infrastrukturës së PIK dhe kompletimin me pajisje bashkëkohore për inspektimet veterinare, fitosanitare dhe produkteve ushqimore.

Qëllimet strategjike të bashkëpunimit brenda agjencisë për Shërbimin Sanitar Antiepidemik:

1. Kuadri ligjor rregullator. Do të synohet në përafrimin e plotë të ligjeve për agjencinë me legjislacionin komunitar.

2. Kuadri institucional. Do të përmirësohet ndërtimi strukturor i SHSA, me qëllim që ajo të shtrihet në pikat kryesore të kalimit të kufirit, bazuar në standardet e BE-së.

3. Procedurat. Do të hartohen procedura standarde të punës së këtij shërbimi, sipas Rregullores Ndërkombëtare Sanitare dhe praktikave të mira.

4. Burimet njerëzore dhe trajnimi. Do të përmirësohen kriteret e rekrutimit të personelit që do të operojë në kufi dhe do të trajnohen në vazhdimësi.

5. Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe IT. Do të synohet në shtrirjen dhe përmirësimin e mjeteve të komunikimit në të gjitha nivelet e SHSA, me qëllim përmirësimin e shkëmbimit të informacionit brenda saj duke shfrytëzuar intranet *gov.al*.

6. Infrastruktura dhe pajisjet. Do të punohet për përmirësimin e ambienteve të punës në bashkëpunim me agjencitë e tjera të përfshira në MIK dhe do të bëhet kompletimi me pajisje bashkëkohore.

Qëllimet strategjike për bashkëpunimin ndërmjet agjencive të Policisë Kufitare dhe Migracionit, Shërbimin Doganor Shqiptar, Autoritetin Kombëtar i Ushqimit, Shërbimin Sanitar Antiepidemik dhe agjencive të përfshira indirekt në MIK:

1. Kuadri ligjor rregullator. Do të synohet të bëhet përafrimi i plotë me legjislacionin e BE-së për menaxhimin e integruar të kufirit, duke miratuar akte administrative për forcimin e bashkëpunimit ndëragjenci për të katër komponentët e Strategjisë.

2. Kuadri institucional. Do të përshtatet struktura e agjencive të kufirit me ato të vendeve të BE-së, sidomos Shërbimi Sanitar Antiepidemik. Të gjitha agjencitë do të punojnë për të parashikuar ndryshime në strukturë për aplikimin real të masave plotësuese për kontrollin në territor. Do të punohet për krijimin e një qendre kombëtare koordinimi për menaxhimin e integruar të kufirit. Do të krijohet një mekanizëm ndëragjenci për kontrollet e kontejnerëve në porte.

3. Procedurat. Do të synohet përsosja dhe zbatimi 100% i tyre në aktivitetin kufitar. E rëndësishme për të ardhmen është zhvillimi i procedurave të punës së AKU-së dhe Shërbimit Sanitar Antiepidemik, me qëllim standardizimin e punës së tyre në kufi dhe lehtësimin e shkëmbimit të informacionit. Do të hartohen procedura të përbashkëta ndërmjet agjencive sidomos për kontrollet mjekësore në linjën e II.

4. Burimet njerëzore dhe trajnimi. Do të miratohen kritere të njëjta me ato që aplikojnë vendet e BE-së për rekrutimin, përzgjedhjen dhe trajnimin e personelit të agjencive të përfshira në MIK. Parashikimi i kritereve do të bëhet në bashkëpunim me të gjitha agjencitë.

5. Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe IT. Do të zgjerohet komunikimi me agjencitë e tjera që nuk janë të përfshira direkt në MIK. Rëndësi merr vendosja e një komunikimi me fleksibël ndërmjet agjencive, me qëllim shkëmbimin në kohë reale të informacionit që lidhet me MIK.

6. Infrastruktura dhe pajisjet. Do të përmirësohet infrastruktura e agjencive kufitare për realizimin e misionit të tyre, sidomos AKU (magazina frigoriferike për produktet me origjinë shtazore dhe joshtazore dhe magazina për materialet mbjellës dhe shumëzues bimor) dhe Shërbimit Sanitar Antiepidemik (për izolimin materialeve të dyshuara me ndotje radioaktive dhe karantinimin e shtetasve që dyshohen për sëmundje të rrezikshme).

Qëllimet strategjike për bashkëpunimin ndërkombëtar për Policinë Kufitare dhe Migracionit:

1. Kuadri ligjor rregullator. Do të synohet në hartimin e akteve ligjore dhe nënligjore të përafruara plotësisht me ligjet komunitare, lidhjen e marrëveshjeve me aktorët ndërkufitarë dhe ndërkombëtarë për sistemin e sigurisë kufitare.

2. Kuadri institucional. Do të synohet në bashkëpunim me fqinjët dhe praktikat e mira të BE-së, të punohet për përafrime strukturore me qëllim që të ecet paralel me masat e tjera dhe sidomos lidhur me masat plotësuese për kontrollin në territor.

3. Procedurat. Do të synohet që të përditësohen këto procedura në përshtatje me proceduat e BE-së për kufijtë e jashtëm dhe sidomos për masat plotësuese për kontrollin ne territor.

4. Burimet njerëzore dhe trajnimi. Do të synohet që përzgjedhja e personelit të jetë në funksion të realizimit të aktiviteteve të përbashkëta ndërkufitare dhe me gjerë. Vëmendja do të përqendrohet në aktivitetet e përbashkëta, si operacione, patrullime, shkëmbime të informacionit dhe zbatimit në praktikë të masave plotësuese për kontrollin në territor.

5. Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe IT. Do të synohet një shkëmbim i shpejtë i informacionit me agjencitë homologe në interes të zbatimit të misionit të tyre, nëpërmjet krijimit të qendrave të përbashkëta të bashkëpunimit policor dhe masave plotësuese për kontrollin në territor.

6. Infrastruktura dhe pajisjet. Do të krijohen sa më shumë PKK të përbashkëta, do të synohet përdorimi i përbashkët i pajisjeve. Vëmendja do të përqendrohet tek pajisjet për zhvillimin e masave plotësuese për kontrollin në territor.

Qëllimet strategjike për bashkëpunimin ndërkombëtar për Shërbimin Doganor Shqiptar:

1. Kuadri ligjor rregullator. Do të bashkëpunohet me strukturat e Delegacionit të BE-së, të Komisionit Evropian dhe të OBD për përafrimin e plotë të legjislacionit doganor me atë të vendeve anëtare të BE-së.

2. Kuadri institucional. Do të përmirësohet në vijimësi organizimi i SHDSH, në linjë me praktikat e mira të vendeve anëtare të BE-së dhe rekomandimet përkatëse të Organizatës Botërore të Doganave.

3. Procedurat. Do të vijojë përmirësimi dhe thjeshtimi i procedurave doganore, për t'u përafruar plotësisht me ato të vendeve anëtare të BE-së, me qellim lehtësimin e tregtisë së ligjshme dhe shkëmbimeve tregtare, qarkullimin e udhëtarëve dhe rritjen e cilësisë së kontrolleve kufitare.

4. Burimet njerëzore dhe trajnimi. Do të vijojë përmirësimi i procedurave të rekrutimit, promovimit dhe kualifikimit bazë e atij ekspert, bazuar në një strategji të burimeve njerëzore të ndërtuar mbi praktikat e mira të vendeve anëtare të BE-së.

5. Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe IT. Do të vijojë realizimi i planeve për rritjen e nivelit dhe cilësisë në shkëmbimin e informacionit me vendet

fqinje, të rajonit dhe me gjerë, nëpërmjet zbatimit e përdorimit të metodave e mjeteve të TI, sipas praktikave e mira të vendeve anëtare të BE-së.

6. Infrastruktura dhe pajisjet. Do të vijojë përmirësimi i infrastrukturës doganore dhe inventarit të pajisjeve e mjeteve të kontrollit kufitar, në linjë me standardet e praktikat e mira të vendeve anëtare të BE-së, në funksion të garantimit të lehtësimit të qarkullimit ndërkufitar të mallrave, mjeteve e udhëtareve, duke rritur njëkohësisht efikasitetin dhe efektivitetin e kontrollit të tyre.

Qëllimet strategjike për bashkëpunimin ndërkombëtar për Autoritetin Kombëtar i Ushqimit:

1. Kuadri ligjor rregullator. Do të synohet përafrimi i plotë i kuadrit ligjor me vendet e BE-së.

2. Kuadri institucional. Do të synohet që ndryshimet e mundshme strukturore të jenë të tilla që të lehtësojnë bashkëpunimin ndërkufitar dhe ndërkombëtar.

3. Procedurat. Do të synohet zhvillimi i procedurave për inspektimet në PIK, bazuar në praktikat e mira të BE-së, dhe realizimi i zbatimit 100% të tyre.

4. Burimet njerëzore dhe trajnimi. Do të synohet përcaktimi i kritereve të rekrutimit dhe trajnimit sipas standardeve të BE-së, me qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar.

5. Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe IT. Do të synohet në kompletimin e shërbimit me pajisje që lehtësojnë shkëmbimin e informacionit me agjencitë homologe të vendeve të tjera.

6. Infrastruktura dhe pajisjet. Do të synohet në përmirësimin e infrastrukturës dhe kompletimin me pajisje inspektimi në bashkëpunim me vendet fqinje, me qëllim përdorimin e përbashkët të tyre, sidomos në PKK të përbashkëta.

Qëllimet strategjike për bashkëpunimin ndërkombëtar për Shërbimin Sanitar Antiepidemik:

1. Kuadri ligjor rregullator. Do të synohet në përafrimin e plotë ligjor me legjislacionin komunitar për çështjet që kanë të bëjnë me bashkëpunimin dy dhe shumëpalësh.

2. Kuadri institucional. Do të përmirësohet struktura aktuale e SHSA, duke u mbështetur në përvojat e mira, me qëllim që të lehtësojë bashkëpunimin me agjencitë homologe të vendeve fqinje dhe më gjerë.

3. Procedurat. Do të hartohen procedura standarde me qëllim njësimin e tyre me ato të vendeve të BE-së, për të forcuar bashkëpunimin me agjencitë homologe të vendeve të tjera.

4. Burimet njerëzore dhe trajnimi. Do të synohet në përcaktimin e kritereve të qarta për rekrutimin e personelit që punon në kufi, me qëllim që të lehtësojë komunikimin dhe shkëmbimin e informacionit.

5. Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe IT. Do të përmirësohet linja e komunikimit me agjencitë homologe të vendeve të tjera për shkëmbimin e informacionit bazuar në paralajmërimin e hershëm, në rastet e ngjarjeve shëndetësore me rrezik për publikun, transportit të mallrave të dyshuara me radioaktivitet dhe mallrave të rrezikshme në përgjithësi.

6. Infrastruktura dhe pajisjet. Do të synohet në krijimin e kushteve të punës në kufi për inspektorët sanitarë, me qëllim kryerjen e aktiviteteve të përbashkëta me homologët e tyre në kufi dhe përdorimin e përbashkët të pajisjeve.

Qëllimet strategjike për masat plotësuese për kontrollin në territor në Policinë Kufitare dhe Migracionit:

1. Kuadri ligjor rregullator. Do të synohet nga të gjitha agjencitë identifikimi i masave plotësuese për kontrollin në territor, hartimi dhe miratimi i kuadrit ligjor të nevojshëm dhe planifikimi i burimeve financiare dhe administrative për zbatimin e tyre në praktikë. Agjencitë e kufirit do të planifikojnë zbatimin e këtyre masave në linjë me rekomandimet e BE-së dhe praktikat e mira të shërbimeve kufitare të vendeve anëtare.

2. Kuadri institucional. Do të bëhet një studim për zbatimin në praktikë të masave plotësuese për kontrollin në territor dhe përbërjen e grupeve të lëvizshme që do t'i zbatojnë ato. Do të përmirësohet menaxhimi i riskut, mbledhja e informacionit dhe analiza e tij, kontrollet në territor (akse rrugore, subjektet tregtare), etj., zbatimi i të cilave do të kontribuojë në garantimin e cilësisë së kontrolleve kufitare.

3. Procedurat. Do të rishikohen procedurat e grupeve për zbatimin e masave plotësuese për kontrollin në territor, bazuar në zhvillimet në vendet e BE-së, dhe të hartohen procedura të njëjta me ato Schengen nga të gjitha agjencitë.

4. Burimet njerëzore dhe trajnimi. Do të përcaktohen kriteret e përzgjedhjes së personelit të grupeve zbatuese për masat plotësuese për kontrollin në territor dhe do të përgatiten e zbatohen programe trajnimi për këtë qëllim.

5. Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe IT. Do të synohet që për zbatimin e masave plotësuese për kontrollin në territor të pajisen me mjete elektronike komunikimi, për të pasur komunikim të përhershëm gjatë zbatimit në praktikë këtyre masave.

6. Infrastruktura dhe pajisjet. Do të synohen grupet e zbatimit të masave plotësuese për kontrollin në territor të jenë të kompletuara me pajisje elektronike të stacionuara në mjete për të pasur informacione në kohë reale për aktivitetin në kufi, si në TIMS, ASYCUDA WORLD ashtu dhe SMARTDEC.

Qëllimet strategjike për bashkëpunimin në migracionin, azilin dhe vizat:

1. Kuadri ligjor rregullator

- Do të përmirësohet legjislacioni për migracionin në përputhje me direktivat europiane dhe rekomandimet e BE-së.

- Do të synohet që ligji për azilin të jetë plotësisht sipas legjislacionit komunitar.

- Do të realizohet përfundimi dhe zbatimi i marrëveshjeve për përfaqësim të shërbimit konsullor në një vend të tretë.

2. Kuadri institucional

-Do të zhvillohen kapacitetet administrative në funksion të zbatimit në praktikë të legjislacionit për migracionin dhe azilin.

-Do të bëhet identifikimi dhe plotësimi i kapaciteteve administrative për zbatimin e marrëveshjeve.

3. Procedurat

- Do të përafrohen plotësisht procedurat për migracionin dhe azilin, me standardet e BE-së.

- Do të përmirësohen procedurat e lëshimit te vizave duke bërë përafrimin e plotë me procedurat e Kodit Schengen.

4. Burimet njerëzore dhe trajnimi. Do të përmirësohet sistemi i administrimit të burimeve njerëzore që merret me çështjet e migracionit, azilit dhe lëshimit të vizave, përfshirë zhvillimin dhe zbatimin e programeve për trajnime specifike.

5. Komunikimi dhe shkëmbimi i informacionit dhe IT

-Do të synohet përmirësimi i evidentimit të migrantëve dhe azilkërkuesve, me qëllim integrimin e informacionit respektiv dhe lehtësimin e shkëmbimit të informacionit ndëragjenci dhe ndërkombëtar.

- Do të ngrihet rrjet i centralizuar i teknologjisë së informacionit dhe i bazës së të dhënave, që do të lehtësojë aplikimin e qytetarëve pranë zyrave konsullore shqiptare jashtë vendit, me synim zbatimin në praktikë të sistemit e-visa sipas standardeve Schengen.

6. Infrastruktura dhe pajisjet

- Do të përmirësohet infrastruktura për pritjen, akomodimin dhe intervistimin e migrantëve dhe azilkërkuesve, në bashkëpunim me agjencitë e përfshira në këtë proces, me qëllim që të arrihen standardet e BE-së.

- Do të përmirësohen komponentët që mundësojnë funksionimin në parametrat e standardeve Schengen të sistemit e-viza, në mënyrë të veçantë pajisjet ku administrohet baza e të dhënave, sistemet e sigurisë fizike dhe informatike për mbrojtjen e sistemit dhe të të dhënave personale.

## KAPITULLI 3
## OBJEKTIVAT E POLITIKËS DHE PRODUKTET MADHORE DHE KUADRI INSTITUCIONAL

1. Forcimi i masave për luftën kundër krimit ndërkufitar dhe trafiqeve të paligjshme me synim rritjen e standardeve të sigurisë së kufijve në parametrat e vendeve të BE-së.

2. Rritja e standardeve për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufijve nëpërmjet aplikimit të praktikave më të mira për menaxhimin e integruar të tij.

3. Krijimi i një kuadri ligjor të përshtatshëm dhe të harmonizuar me standardet e BE dhe të Rregullores Schengen.

4. Ngritja e një sistemi masash parandaluese për migrimin e paligjshëm, bazuar në kuadrin ligjor dhe praktikat e mira të vendeve të BE-së.

5. Të përafrohet plotësisht me standardet e BE-së qarkullimi i mallrave, mjeteve dhe udhëtarëve në kufi, duke garantuar lehtësi për tregtinë e ligjshme dhe kufij të sigurt.

6. Përafrimi i plotë i sistemit elektronik të lëshimit të vizave, e-viza me standardet e Rregullores Schengen.

Objektivat specifikë

1. Rritja e forcës zbuluese kundër krimit ndërkufitar nëpërmjet:

- Zbulueshmëria e veprave penale do të rritet në sajë të përdorimit të sistemeve informatike.

- Rritjen e profesionalizmit dhe kapaciteteve teknike për goditjen e fenomenit të përdorimit të dokumenteve të falsifikuara për kalimin e kufirit.

1.2 Reduktimi i trafiqeve të paligjshme nëpërmjet kufirit, nëpërmjet:

- Marrjes së masave parandaluese dhe rritjes së forcës goditëse kundër aktivitetit të kundërligjshëm që ka të bëjë me trafikimin e personave, armëve, drogës, mallrave etj.

2. Standardizimi i PKK sipas standardeve të BE dhe Kodit Schengen:

-Për PKK të kategorisë së parë: nga 85% në vitin 2013 në 100 % në vitin 2020.

-Për PKK të kategorisë së dytë: nga 75% në vitin 2013 në 100 % në vitin 2020.

-Për PKK të kategorisë së tretë: nga 75% në vitin 2013 në 100 % në vitin 2020.

3. Krijimi i një kuadri ligjor të përshtatshëm dhe të harmonizuar me standardet BE dhe Kodin Schengen, nëpërmjet:

-Përputhjes së plotë të kuadrit ligjor për kufijtë e jashtëm të BE-së dhe aktet që kanë të bëjnë me menaxhimin efektiv dhe efecient të burimeve njerëzore, materiale dhe financiare.

-Përditësimit të akteve ligjore dhe nënligjore me ndryshimet që do të kenë rregulloret e BE-së për kufijtë e jashtëm.

4. Parandalimi dhe ulja e rasteve të imigrimit të paligjshëm, shtetas të huaj të kapur në territorin e Shqipërisë me dokumente të parregullta, nëpërmjet:

- Analizës së saktë të riskut;

- Manovrimit të forcave në drejtimet më problematike;

- Kompletimit me pajisje bashkëkohore për parandalimin e migracionit ilegal.

7. Përmirësimi i sistemit elektronik të lëshimit të vizave e-viza me standardet e Kodit Schengen:

- Do të synohet përafrimi i plotë i sistemit të lëshimit të vizave me praktikat e mira të vendeve të BE dhe Rregulloren Schengen.

Agjencitë pjesëmarrëse

Agjencitë kryesore shtetërore që operojnë në kufi janë: Policia Kufitare dhe Migracionit (PKM)/Policia e Shtetit; Shërbimi Doganor Shqiptar (SHDSH); Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) dhe Shërbimi Sanitar Antiepidemik (SHSA).

Policia e Shtetit/Policia Kufitare dhe Migracionit (PKM)

Policia Kufitare dhe Migracionit është pjesë përbërëse e Policisë së Shtetit dhe është përgjegjëse për kontrollet dhe mbikëqyrjen e kufirit. Detyra e PKM përcaktohet në nenin 6 të ligjit nr. 9861, datë 24.1.2008 "Për kontrollin dhe mbikëqyrjen e kufirit shtetëror".

Në varësi të Policisë Shtetit/Departamentit për Kufirin dhe Migracionin janë:

- Në nivel qendror: Drejtoria e Shërbimeve Operacionale; Drejtoria e Migracionit dhe Ripranimeve; Administrata dhe Sektori i Analizës së Riskut.
- Në nivel rajonal: drejtoritë rajonale të kufirit dhe migracionit dhe komisariate të PKM. Territori që do të mbulojnë drejtoritë/komisariatet përcaktohet me akte administrative bazuar në analizën e riskut.
- Në nivel lokal: stacionet e PKM.

Shërbimi Doganor Shqiptar (SHDSH)

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Shërbimit Doganor dhe nëpunësve doganorë përkufizohen në Kodin Doganor, rregulloret në fuqi për administratën shtetërore dhe rregulloret e brendshme të SHDSH, dokumenteve strategjike sektoriale.

Struktura e SHDSH organizohet në dy nivele:

- Nivel qendror, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, me: Departamentin Teknik, Departamentin Administrativ, Departamentin Operativ Hetimor dhe Departamentin e Akcizës.
- Nivel lokal: degët doganore

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit(AKU)

- Ka në përbërje Drejtorinë e Menaxhimit të Riskut dhe Koordinimit të Inspektimit (inspektimit të ushqimit, ushqimit për kafshë me origjinë shtazore dhe operatorët e biznesit (veterinar); inspektimin të mbrojtës së bimëve dhe inputeve bujqësore (fitosanitar) dhe inspektimi të ushqimit, ushqimit për kafshë me origjine jo shtazore dhe operatoret e biznesit (ushqimit); Drejtoria e Vlerësimit të Riskut dhe Drejtoria e Shërbimeve të Brendshme.
- Në nivel rajonal, drejtoritë rajonale të AKU-së kanë në vartësi inspektorin karantinor të PIK (të tre inspektimet).
- Drejtoria e Shëndetit Publik /Shërbimi Sanitar Antiepidemik (SHSA)

Është pjesë e Drejtorisë së Shëndetit Publik në Ministrinë e Shëndetësisë, në përbërje të së cilës janë:

- drejtoritë rajonale e shëndetësisë;
- drejtoritë e shëndetit publik;
- agjencitë e tjera qe përfshihen ne MIK;
- Shërbimi Konsullor;
- Roja Bregdetare;
- Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD);
- Administrata Detare (Drejtoria e Përgjithshme Detare; Autoriteti Shtetëror i Sigurisë Portuale; kapiteneritë e porteve; Kontrolli Shtetëror Portual; Kontrolli Shtetëror i Flamurit; Regjistri i Mjeteve Lundruese të RSH-së; Regjistri i Detarëve të RSH-së;
- Agjencia Kombëtare e Trafikut Ajror;
- SHISH.

## KAPITULLI 4
## BURIMET FINANCIARE

Pa dyshim, çështja e buxhetit është një prej faktorëve kryesorë që do të garantojë zbatimin e Strategjisë MIK. Duke pasur parasysh se katër janë agjencitë kryesore e përfshira në MIK (Policia Kufitare dhe e Migracionit, Shërbimi Doganor, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Shërbimi Sanitar Antiepidemik), dhe ato të përfshira në MIK, si Roja Bregdetare, Shërbimi Konsullor, etj., kërkohen detyrimisht disa angazhime buxhetore nga Qeveria dhe ministritë respektive.

Të gjitha agjencitë e përmendura financohen nga Buxheti i Shtetit dhe kanë buxhetin e tyre të miratuar si pjesë e buxhetit të ministrive përkatëse në fillim të çdo viti buxhetor.

Të gjitha agjencitë e përfshira në MIK, çdo vit gjatë procesit të hartimit të kërkesave buxhetore afatmesme, duhet të sigurojnë përfshirjen në këto kërkesa të aktiviteteve dhe kostove përkatëse të parashikuara në planin e veprimit të MIK.

Shpenzimi i buxhetit MIK duhet të bashkërendohet në marrëveshje me të gjitha agjencitë. Për këtë qëllim Komiteti Ndërministror i MIK dhe Koordinatori Kombëtar për MIK, duhet të marrin përgjegjësi në lidhje me monitorimin e përdorimit të buxhetit për MIK. Pa angazhime buxhetore transparente dhe të përcaktuara qartë do të ishte e vështirë jo vetëm të vihej në zbatim jo vetëm Strategjia MIK dhe Plani i saj i Veprimit, por edhe garantimi i punës profesionale të të gjitha agjencive.

Gjithashtu nga agjencitë e përfshira në MIK duhet të hartohen projekte të besueshme dhe afatgjata me qëllim thithjen e financimeve të BE dhe partnereve të tjerë ndërkombëtarë.

Projektbuxheti për vitet 2014-2020 në milion lekë.

| Nr. | Vitet | PKM | SHDSH | AKU | SHSA |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2014 | 1,819,064 | 1,778,650 | 1,690,000 | 5,000,000 |
| 2 | 2015 | 1,974,790 | 1,849,200 | 1,433,000 | 2,000,000 |
| 3 | 2016 | 1,903,966 | 2,157,400 | 2,340,000 | 4,000,000 |
| 1.5 | Të rishikohet memorandumi i bashkëpunimit ndërmjet PSHSH dhe TIA. | 1. Ngritja e grupit të punës;<br>2. Përgatitja e draftit<br>3. Miratimi;<br>4. Zbatimi. | 2014 | Kosto administrative | PSHSH/PKM<br>MTI<br>TIA | Memorandumi është në përputhje me Programin Kombëtar të Sigurisë në Aviacion. |
| **B. KUADRI INSTITUCIONAL** | | | | | | |
| **2. OBJEKTIVI STRATEGJIK:**<br>Përmirësim të organizimit strukturor të agjencive të kufirit me qëllim lehtësimin e bashkëpunimit, dhe të krijohet një mekanizëm kombëtar për MIK. | | | | **Programi buxhetor:**<br>Buxheti i Shtetit dhe donatorë | | **Treguesi/t i rezultatit:**<br>Është ngritur mekanizmi i koordinimit të MIK (Koordinatori Kombëtar i MIK). |
| **Nr.** | **Nënobjektiv** | **Veprimet/masat për t'u ndërmarrë** | **Koha e realizimit** | **Burimet financiare të nevojshme** | **Institucionet përgjegjëse** | **Treguesit e monitorimit të masave** |
| 2.1 | Të krijohet një mekanizëm kombëtar për koordinimin e punës për realizimin e kërkesave të MIK. | 1. Përgatitja e propozimit;<br>2. Hartimi i draftit të VKM-së;<br>3. Miratimi;<br>4. Zbatimi. | 2014-2015 | 10 000 000 lekë në vit Buxheti i Shtetit | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>MD<br>MASH<br>Partnerët ndërkombëtarë | Koordinimi i aktiviteteve për realizimin e angazhimeve të Qeverisë Shqiptare për MIK, është përmirësuar dukshëm me krijimin e këtij mekanizmi. Anomalitë gjatë implementimit të planit të veprimit janë minimizuar. |
| 2.2 | Të krijohet një Qendër Kombëtare Koordinimi për Menaxhimin e Integruar të Kufirit. | 1. Ngritja e grupit të punës;<br>2. Hartimi i draftit;<br>3. Marrja e mendimit<br>4. Miratimi me VKM. | 2016-2017 | 60.000.000 lekë në vit Buxheti i shtetit + do kërkohen donatorë | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>MD<br>MASH<br>Partnerët ndërkombëtarë | Bashkëpunimi dhe koordinimi i punëve të agjencive të MIK është forcuar. Informacioni shkëmbehet në kohë reale. Lëvizja e shtetasve, mjeteve dhe mallrave bëhet duke eliminuar kohën që kërkohet për shkëmbimin e informacionit ndërmjet agjencive. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.3 | Të krijohet një mekanizëm ndëragjenci për kontrollet e kontejnerëve në porte. | 1. Ngritja e grupit të punës;<br>2. Hartimi i draftit;<br>3. Marrja e mendimit<br>4. Miratimi. | 2014-2015 | Kosto administrative | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>Partnerët ndërkombëtarë | Siguria në porte është rritur. Agjencitë punojnë bashkë për kontrollin e mjeteve të transportit.<br>Aktiviteti i kundërligjshëm në porte është ulur.<br>Identifikimi i veprimeve të kundërligjshme është në rritje të vazhdueshme. |
| 2.4 | Të forcohet bashkëpunimi dhe koordinimi ndëristitucional për MIK në kufirin blu, forcimi i kapaciteteve njerëzore dhe teknike dhe të përmirësohen sistemet e IT. | 1. Krijohet grupi i punës me pjesëmarrjen e të gjithë aktorëve;<br>2. Identifikimi i mangësive dhe prezantimi i propozimeve;<br>3. Përgatitja e projektit;<br>4. Diskutimi i projektit;<br>5. Miratimi;<br>6. Zbatimi. | 2015-2017 | Kosto administrative | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>Agjencitë e tjera pjese e QNOD<br>Partnerët ndërkombëtarë | Janë ngritur mekanizma të qëndrueshëm dhe është arritur performancë bashkëkohore në harmonizimin e operacioneve dhe aktiviteteve.<br>Është përmirësuar menaxhimi dhe bashkëpunimi në menaxhimin e personelit dhe aseteve.<br>Është ngritur në nivel të lartë aftësimi tekniko-profesional dhe menaxhues në kufirin blu.<br>Është krijuar një mekanizëm i qëndrueshëm për monitorimin e hapësirës detare dhe janë përmirësuar sistemet SIVHD, MEMEX, Blu Box, TETRA dhe është krijuar baza e të dhënave për mjetet lundruese. |
| 2.5 | Të bashkëpunohet me pushtetin lokal dhe banorët e zonave në afërsi të kufirit shtetëror për shkëmbimin e informacionit dhe ndërgjegjësimin e banorëve për respektimin e rregullave të lëvizjes në afërsi të kufirit shtetëror. | 1. Parashikimi i veprimeve në Strategjinë e Policimit në Komunitet;<br>2. Të përgatiten fletëpalosje dhe të shpërndahen në qendrat e banuara në afërsi të kufirit. | 2014 dhe në vazhdimësi | Kosto administrative<br><br>2 000 000 lekë | MPB/PSHSH/PKM<br>Pushteti lokal | Banorët informojnë PKM për problemet që hasin në qendrat e banuara në afërsi të kufirit.<br>Banorët janë ndërgjegjësuar për respektimin e rregullave të lëvizjes në afërsi të kufirit shtetëror. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2.6 | Në bashkëpunim me Drejtorinë e Koordinimit me Prefekturat, të zhvillohet një takim me kryetarët e komunave dhe bashkive, që kanë detyrime në vijën bregdetare, me qëllim njohjen me detyrimet për të garantuar sigurinë e përdoruesve të detit dhe higjienën në plazhe. | 1. Përgatitja e takimit;<br>2. Njoftimi i pjesëmarrësve;<br>3. Zhvillimi i takimit | Mars 2014 | Kosto administrative<br>Donatorë | Departamenti për Kufirin e Migracionin;<br>Drejtoria e Koordinimit me Prefekturat | Pushteti vendor zbaton detyrimet ligjore në lidhje me sigurinë e përdoruesve të detit dhe higjienën e plazheve publike. |
| 2.7 | Të organizohet takim me bizneset që veprojnë përgjatë bregdetit, me qëllim njohjen me detyrimet që kanë në fushën e sigurisë së mjeteve argëtuese të pushimit, apo dhe përdoruesve individualë të bregdetit, si dhe mundësia e sponsorizimive nga ana e tyre të moleve të lëvizshme apo vendosjen e shenjave të kufizimit në det. | 1. Përgatitja e takimit;<br>2. Njoftimi i pjesëmarrësve;<br>3. Zhvillimi i takimit | Mars 2014 | Kosto administrative<br>Donatorë | Departamenti për Kufirin e Migracionin;<br>Drejtoria e Koordinimit me Prefekturat | Bizneset zbatojnë detyrimet ligjore në lidhje me sigurinë e përdoruesve të mjeteve argëtuese të pushimit detare dhe higjienën e plazheve publike. Kanë marrë përgjegjësi për ndërtimin e moleve të lëvizshme dhe vendosjen e shenjave të kufizimit në det. |
| 2.8 | Të afishohen në sitin e Policisë së Shtetit, në gjuhët shqip dhe anglisht, të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore për përdorimin e mjeteve lundruese, rregullat për pajisjen me certifikatën e përdorimit, si dhe të akteve ligjore sipas neneve përkatëse që parashikojnë sanksione e ndëshkime për shkelësit e rregullave. | 1. Përgatitja e materialit që do afishohet;<br>2. Pasqyrimi në faqen WEB. | Shkurt 2014 | Kosto administrative | Departamenti për Kufirin e Migracionin | Shtetasit shqiptarë dhe të huaj informohen në gjuhët shqip dhe anglisht me të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore për përdorimin e mjeteve lundruese, rregullat për pajisjen me certifikatën e përdorimit, si dhe të akteve ligjore sipas neneve përkatëse që parashikojnë sanksione e ndëshkime për shkelësit e rregullave. |
| 2.9 | Të përgatitet dhe të përfundojë hedhja në hartë e të gjithë plazheve publike me dimensionet e përmasat sipas kufizimeve, si dhe të vendbazimeve të mjeteve lundruese, për t'u zbatuar konkretisht këto nga ana e organeve kompetente. | 1. Përgatitja e hartës;<br>2. Njohja e pushtetit vendor dhe bizneseve;<br>3. Zbatimi në terren. | Mars 2014 | Kosto administrative | Departamenti për Kufirin e Migracionin | Zonat e miratuara për ushtrimin e aktiviteteve janë të evidentuara dhe lehtësisht të monitorueshme. |
| 2.10 | Në fillim të çdo sezoni turistik, Policia e Shtetit të përgatisë planin e masave | 1. Identifikimi i problematikave; | Çdo vit | Kosto administrative | Departamenti për Kufirin e Migracionin | Veprimtaria e policisë gjatë sezoneve turistike bazohet në masa parandaluese, |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | në bashkëpunim edhe me aktorë të tjerë për të garantuar sigurinë e pushuesve gjatë sezonit turistik. | 2. Përgatitja e planit të masave;<br>3. Miratimi;<br>4. Zbatimi. | | | | bazuar në problematikat e hasura. |
| **C. PROCEDURA** | | | | | | |
| **3. OBJEKTIVI STRATEGJIK:**<br>Hartimi i procedurave të përbashkëta pune për aktivitetin e agjencive të MIK dhe të synohet zbatimi 100% i tyre në aktivitetin kufitar. | | | | **Programi buxhetor:**<br>Buxheti i Shtetit dhe donatorë | | **Treguesi/t i rezultatit:**<br>Agjencitë kanë procedura pune sipas standardeve të BE-së. Të gjitha mekanizmat e krijuara punojnë në bazë të procedurave standarde të miratuara dhe zbatojnë 100 % ato. |
| **Nr.** | **Nënobjektiv** | **Veprimet/masat për tu ndërmarrë** | **Koha e realizimit** | **Burimet financiare të nevojshme** | **Institucionet përgjegjëse** | **Treguesit e monitorimit të masave** |
| 3.1 | Të hartohen procedurat e punës për mekanizmin e Koordinatorit Kombëtar të MIK. | 1. Përgatitja e procedurave;<br>2. Marrja e mendimit;<br>3. Miratimi me VKM;<br>4. Zbatimi. | 2014-2016 | Kosto administrative<br>300 000 lekë | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>Partnerët ndërkombëtarë | Koordinatori Kombëtar i MIK dhe stafi i tij punon në bazë të procedurave të miratuara. |
| 3.2 | Të hartohen procedurat e punës për Qendrën Kombëtarë të Koordinimit për Menaxhimin e Integruar të Kufirit. | 1. Ngritja e grupit të punës;<br>2. Hartimi i draftit;<br>3. Marrja e mendimit<br>4. Miratimi;<br>5. Zbatimi. | 2016-2017 | Kosto administrative<br>400 000 lekë | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>Partnerët ndërkombëtarë | Qendra Kombëtarë e Koordinimit për MIK monitoron 24/7 situatën në kufirin shtetëror. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet agjencive bëhet në kohë reale. Ulen vonesat e qarkullimit të shtetasve, mjeteve dhe mallrave. |
| 3.3 | Të krijohet një mekanizëm ndëragjenci për kontrollet e kontejnerëve në porte. | 1. Ngritja e grupit të përbashkët të punës;<br>2. Hartimi i draftit;<br>3. Marrja e mendimit<br>4. Miratimi;<br>5. Zbatimi. | 2014-2015 | Kosto administrative | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>Partnerët ndërkombëtarë | Kontrolli i kontejnerëve bëhet nga grupe të përbashkëta, të pajisur me mjetet e duhura dhe personel të mirëtrajnuar. Identifikimi i aktiviteteve të paligjshme është rritur në masën 97 %. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 3.4 | Të përmirësohet sistemi i përpunimit të aplikantëve për azil në pikat e kalimit të kufirit, lëshimin e dokumenteve atyre që t'u jepet mbrojtje plotësuese dhe për vlerësimin periodik për të vlerësuar tendencat e reja të migracionit. | 1. Ngritja e grupit te punës;<br>2. Përgatitja e draftit;<br>3. Marrja e mendimit;<br>4. Miratimi;<br>5. Zbatimi. | Viti 2013 dhe në vazhdimësi | Kosto administrative | MPB/PSHSH/PKM/<br>Drejtoria për Shtetësinë dhe Refugjatët<br>MPJ | Është rishikuar dhe implementuar një mekanizëm i qëndrueshëm për vlerësimin dhe përpunimin e azilkërkuesve në PKK dhe në territor, për pajisjen me karta identiteti për personat që iu është dhënë mbrojtje plotësuese.<br>Është krijuar një mekanizëm i qëndrueshëm dhe efikas për të vlerësuar azilkërkuesit.<br>Hartohen raporte me të dhëna zyrtare dhe raporte vjetore të MPB/PSH, raporte të OJF, OSBE dhe ambasadat. |
| **D. BURIMET NJERËZORE DHE TRAJNIMET** | | | | | | |
| **4. OBJEKTIVI STRATEGJIK:**<br><br>Zbatimi i kritereve të njëjta me vendet e BE-së për rekrutimin, përzgjedhjen dhe trajnimin e personelit të agjencive të përfshira në MIK në bashkëpunim me të gjitha agjencitë. | | | | **Programi buxhetor:**<br>Buxheti i Shtetit dhe donatorë | | **Treguesi/t i rezultatit:**<br>Personeli i përzgjedhur është i aftë të bashkëpunojë dhe të punojë në grupe të përbashkëta. Janë përgatitur programe trajnimi dhe zhvillohen trajnime të përbashkëta.<br>QNOD e ristrukturuar. |
| **Nr.** | **Nënobjektiv** | **Veprimet/masat për t'u ndërmarrë** | **Koha e realizimit** | **Burimet financiare të nevojshme** | **Institucionet përgjegjëse** | **Treguesit e monitorimit të masave** |
| 4.1 | Të rishikohen kriteret e përzgjedhjes së personelit me qëllim që të përcaktohen sipas standardeve të BE-së dhe të ndikojnë në bashkëpunimin ndëmjet agjencive. | 1. Rishikimi i kritereve;<br>2. Përgatitja e materialit;<br>3. Miratimi;<br>4. Zbatimi . | 2016-2017 | Kosto administrative | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>Partnerët ndërkombëtarë | Kriteret e përzgjedhjes së personelit janë të përcaktuara qartë dhe janë sipas standardeve të BE-së.<br>Bashkëpunimi ndërmjet agjencive është forcuar. |
| 4.2 | Të përgatiten dhe zhvillohen programe trajnimi të përbashkëta për agjencitë që operojnë në kufi me synimin forcimin e bashkëpunimit dhe kryerjen e aktiviteteve të përbashkëta. | 1. Ngritja e grupit të punës;<br>2. Hartimi i draftit;<br>3. Miratimi;<br>4. Zhvillimi i trajnimeve. | 2014-2018 | Kosto administrative<br>10 000 000 lekë<br>24 000 euro | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>Partnerët ndërkombëtarë | Personeli që punon në agjencitë kufitare është trajnuar dhe është i aftë të realizojë detyrat e ngarkuara. Është rritur puna e përbashkët për forcimin e sistemit të sigurisë kufitare. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 4.3 | Të rishikohet struktura e QNOD me qëllim që forcohet bashkëpunimi i aktorëve që operojnë në të. | 1. Rishikimi i kritereve;<br>2. Përgatitja e materialit;<br>3. Miratimi;<br>4. Zbatimi. | 2014-2015 | Kosto administrative | QNOD<br>MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>M e Mjedisit<br>Partnerët ndërkombëtarë | Struktura e re në QNOD e implementuar:<br>Jurist për aktet administrative<br>Specialist operacional (4 persona) |
| **E. KOMUNIKIMI DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT DHE IT** | | | | | | |
| **5. OBJEKTIVI STRATEGJIK:**<br><br>Zgjerimi dhe përmirësimi i komunikimit dhe shkëmbimit të informacionit me agjencitë e tjera që nuk janë të përfshira direkt në MIK, vendosja e një komunikimi më fleksibël ndërmjet agjencive me qëllim shkëmbimin në kohe reale të informacionit që lidhet me MIK. | | | | **Programi buxhetor:**<br>Buxheti i Shtetit dhe donatorë | | **Treguesi/t i rezultatit:**<br>Agjencitë kanë krijuar të gjitha modalitetet për shkëmbimin real të informacionit në interes të forcimit të sigurisë kufitare. Shkëmbimi i informacionit bëhet në kohe reale duke lehtësuar qarkullimin e shtetasve, mjeteve dhe mallrave. |
| **Nr.** | **Nënobjektiv** | **Veprimet/masat për t'u ndërmarrë** | **Koha e realizimit** | **Burimet financiare të nevojshme** | **Institucionet përgjegjëse** | **Treguesit e monitorimit të masave** |
| 5.1 | Të realizohet aksesi i PKM në sistemin e regjistrit të mjeteve të transportit dhe në e-gjoba. | 1. Ngritja e grupit të punës;<br>2. Përgatitja e propozimeve;<br>3. Diskutimi;<br>4. Miratimi;<br>5. Zbatimi. | 2015-2017 | Kosto administrative | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>Partnerët ndërkombëtarë | Agjencitë e kufirit kanë aksesin e duhur në data bazat e agjencive respektive për të verifikuar dhe shkëmbyer informacione në interes të forcimit të sistemit të sigurisë kufitare. |
| 5.2 | Të përmirësohet, në bashkëpunim me Kapitanerinë e Porteve, regjistri detar i mjeteve të lundrimit dhe të sigurohet aksesi i plotë në këtë regjistër për PKM. | 1. Të përgatitet propozimi i detajuar;<br>2. Të miratohet nga linjat respektive;<br>3. Të zbatohet. | 2017-2018 | Kosto administrative | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>Partnerët ndërkombëtarë | PKM konsulton regjistrin detar në interes të mbikëqyrjes së hapësires detare. Mjetet identifikohen më mirë nga QNOD dhe shërbimet rajonale të PKM-së. |
| 5.3 | Të përmirësohet shkëmbimi i informacionit nëpërmjet përmirësimit të sistemit të transmetimit RADIOURE, TETRA | 1. Ngritja e grupit të punës;<br>2. Përgatitja e propozimeve; | 2014-2017 | - 63 000 000 lekë<br>- 35 000 000 lekë<br>- 141 120 000 lekë | QNOD<br>Roja Bregdetare dhe përfaqësuesve të ministrive të linjës | Është krijuar një mekanizëm i qëndrueshëm për monitorimin e hapësirës detare dhe janë përmirësuar sistemet SIVHD, MEMEX, Blu Box, |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | dhe vendosja e tri kamerave infra-red, shtimi i dy radarëve në Kepin e Rodonit dhe të Gjuzës. | 3. Diskutimi;<br>4. Miratimi;<br>5. Zbatimi. | | - 76 800 000 lekë<br>- 30 000 000 lekë<br>Buxheti i Shtetit<br>+ donatorë | | TETRA dhe është krijuar baza e të dhënave për mjetet lundruese. Është siguruar grumbullimi dhe përpunimi i informacionit mbi tekniken e re të zbatuar. |
| 5.4 | Të përgatiten plan financiar periodik për mirëmbajtjen e hardware dhe software të SIVHD (Sistemi i Integruar i Vëzhgimit të Hapësirës Detare) | 1. Përgatitja e planit;<br>2. Diskutimi;<br>3. Miratimi;<br>4. Zbatimi. | Çdo vit dhe kur është e nevojshme | 127 022 000 lekë<br>Buxheti i Shtetit +donatorë | Roja Bregdetare<br>QNOD<br>dhe përfaqësuesve të ministrive të linjës | Monitorimi i hapësirës detare është i garantuar dhe realizohet me pajisje bashkëkohore, mirëmbajtja e tyre është e vazhdueshme. |
| 5.5 | Të rikonstruktimet godina e QNO | 1. Hartimi i propozimit;<br>2. Përgatitja e projektit;<br>3. Miratimi;<br>4. Zbatimi. | 2014-2017 | 300 000 euro donatorë në kuadër të IPA dhe Buxheti i Shtetit | QNOD dhe përfaqësuesve të ministrive të linjës | Personeli i QNOD punon në një ambient bashkëkohor dhe me të gjitha parametrat e një qendre kombëtare. |
| 5.6 | Përmirësimi i platformave analizuese dhe informuese ndëragjenci. | 1. Ngritja e grupit të punës;<br>2. Hartimi i projekteve për analizën e riskut GIS dhe VTMIS për shkëmbimin e të dhënave për mjetet detare;<br>3. Miratimi;<br>4. Zbatimi. | 2014-2017 | 165 000 euro<br>800 000 euro<br>Donatorë në kuadër të IPA dhe Buxheti i Shtetit | QNOD dhe përfaqësuesve të ministrive të linjës | Analiza e riskut bëhet sipas parashikimeve të përmirësuara në nivelin e standardeve bashkëkohore. |
| **F. INFRASTRUKTURA DHE PAJISJET** | | | | | | |
| **6. OBJEKTIVI STRATEGJIK:**<br>Hartimi i projekteve dhe planeve për ndërtimin dhe mirëmbajtjen e ambienteve të punës në interes të agjencive të kufirit. | | | | **Programi buxhetor:**<br>Buxheti i Shtetit dhe donatorë | | **Treguesi/t i rezultatit:**<br>Ambientet e punës të agjencive të kufirit janë sipas standardeve të BE-së dhe lehtësojnë punën e agjencive të kufirit për kryerjen e veprimeve të përbashkëta. |
| **Nr.** | **Nënobjektiv** | **Veprimet/masat për t'u ndërmarrë** | **Koha e realizimit** | **Burimet financiare të nevojshme** | **Institucionet përgjegjëse** | **Treguesit e monitorimit të masave** |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 6.1 | Të hartohen projekte për ndërtime/rikonstruksione godinash në interes të forcimit të punës së përbashkët në interes të sigurisë kufitare.<br>1. në PKK Hani i Hotit<br>2. në PKK Morinë<br>3. në PKK Kapshticë<br>4. në PKK Kakavijë | 1. Me grup pune të identifikohen nevojat;<br>2. Hartimi i projekteve.<br>3. Diskutimi me aktorët e tjerë të MIK;<br>4. Miratimi dhe zbatimi i projekteve. | 2014-2017 | - 450 000 euro (TVSH, shpronësime, etj.) Buxheti Shtetit për kostot lokale<br>- Në kuadër të IPA-s<br>1 900 000 euro (IPA 2012)<br>1 100 000 euro (IPA 2012)<br>1 500 000 euro (IPA II)<br>1 500 000 euro (IPA II) | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>Partnerët ndërkombëtarë | Projektet e zbatuara lehtësojnë punën e agjencive kufitare për të realizuar aktivitete të përbashkëta në interes të lëvizjes së lirë të shtetasve, mjeteve, mallrave dhe të forcimit të kontrollit kufitare. |
| 6.2 | Shkëmbimi i informacionit dhe eksperiencave ndërmjet agjencive kufitare dhe autoriteteve të tjera përkatëse për përdorimin efikas dhe efektiv të infrastrukturës, pajisjeve dhe veglave të punës (sisteme me rreze-x, zbulues radiatimi, qen, zbulues kimikatesh, etj.), është krijuar në nivel lokal, rajonal, kombëtar dhe ndërkombëtar. | 1. Identifikohen fushat ku është e nevojshme të shkëmbehet informacion;<br>2. Hartimi i propozimeve;<br>3. Diskutimi me aktorët e tjerë;<br>4. Miratimi dhe aksesi në sistemet respektive. | 2015-2019 | Buxheti i shtetit dhe donatorë ndërkombëtarë | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>Partnerët ndërkombëtarë | Krijimi i një sistemi të rregullt informacioni dhe të ekzistojë shkëmbimi i eksperiencave me autoritetet e tjera. |
| 6.3 | Rritja e kapaciteteve ndëragjenci për dedektimin dhe reagimin ndaj alarmeve të radioaktivitetit në PKK. | 1. Implementimi i projekteve të përgatitura. | 2014-2017 | Buxheti i Shtetit 15% dhe 1 200 000 euro (IPA 2013) | MF/SHDSH<br>MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/ë<br>MPBZHRAU/AKU<br>MAS/Instituti i Fizikës Bërthamore,<br>Partnerët ndërkombëtarë | Skema kombëtare e dedektimit të lëndëve radioaktive është ngritur dhe kapacitetet për përgjigjen ndaj alarmeve janë të organizuara dhe funksionale në bazë të procedurave standarde. |
| 6.4 | Në bashkëpunim me drejtorinë e QNOD të bëhet financimi dhe vendosja e një salle operative (në QNOD) për monitorimin e mjeteve të lundrimit nëpërmjet GPS-it. | 1. Ngritja e grupit të punës;<br>2. Përgatitja e projektit<br>3. Miratimi;<br>4. Zbatimi . | Prill 2014 | Buxheti i Shtetit | Departamenti për Kufirin e Migracionin;<br>Drejtoria e QNOD | Është krijuar nje mekanizëm i qëndrueshëm për identifikimim e mjeteve lundruese nëpërmjet GPS |

BASHKËPUNIMI NDËRKOMBËTAR
POLICIA KUFITARE DHE MIGRACIONIT

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1 KUADRI LIGJOR RREGULLATOR** | | | | | | |
| **1. OBJEKTIVI STRATEGJIK:**<br>Hartimi i akteve ligjore dhe nënligjore të përafruara plotësisht me ligjet komunitare, lidhjen e marrëveshjeve me aktoret ndërkufitare dhe ndërkombëtarë për sistemin e sigurisë kufitare. | | | | **Programi buxhetor:**<br>Buxheti i Shtetit dhe donatorë | | **Treguesi/t i rezultatit:**<br>Legjislacioni është plotësisht në përputhje me legjislacionin komunitar. Marrëveshjet me shtetet fqinje dhe me vendet e BE-së, zbatohen dhe lehtësojnë shkëmbimin e informacionit për goditjen e aktivitetit të paligjshëm nëpërmjet kufirit shtetëror. |
| **Nr.** | **Nënobjektiv** | **Veprimet/masat për t'u ndërmarrë** | **Koha e realizimit** | **Burimet financiare të nevojshme** | **Institucionet përgjegjëse** | **Treguesit e monitorimit të masave** |
| 1.1 | Të nënshkruhen marrëveshje dy dhe shumëpalëshe në drejtim të bashkëpunimit ndërkufitar për të luftuar aktivitetin kriminal duke synuar hetime dhe operacione të përbashkëta. | 1. Të identifikohen fushat dhe vendet me të cilët duhen marrëveshjet;<br>2. Hartimi i drafteve të marrëveshjeve sipas fushave;<br>3. Diskutimi me aktorët e tjerë të MIK;<br>4. Miratimi i marrëveshjeve nga qeveria;<br>5. Miratimi dhe zbatimi i marrëveshjeve. | 2015-2018 | Kosto administrative | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>Partnerët ndërkombëtarë | Zbatimi i marrëveshjeve, patrullimet e përbashkëta, për takimet në tri nivelet, për PKK-të e përbashkëta, për qendrat e përbashkëta të bashkëpunimit policor, për hetimet e përbashkëta dhe operacionet e përbashkëta. Punonjësit e PKM-së marrin pjesë me sukses dhe me performancë të lartë në aktivitetet e organizuara nga FRONTEX dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë në drejtim të forcimit të sistemit të sigurisë kufitare. |
| 1.2 | Të rishikohen marrëveshjet me vendet fqinje për PKK, duke i kthyer në pika të përbashkëta, shtimin e numrit të PKK-ve, analizën e përbashkët të riskut dhe | 1. Të identifikohen fushat dhe vendet me të cilët duhen rishikuar dhe lidhur marrëveshjet; | | Kosto administrative | MPB/PSHSH/PKM | Numri i PKK-ve të përbashkëta është rritur, palët punojnë bashkërisht për të lehtësuar qarkullimin e shtetasve dhe mallrave, por duke synuar rritjen e |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | rritjen e numrit të aktiviteteve të përbashkëta në kufi, me qëllim shkëmbimin e informacionit, forcimin e bashkëpunimit në drejtim të luftës kundër krimit ndërkufitar. | 2. Hartimi i propozimeve;<br>3. Diskutimi me aktorët e tjerë të MIK;<br>4. Miratimi dhe zbatimi i marrëveshjeve. | 2015-2018 | | MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>Partnerët ndërkombëtarë | sigurisë në kufi. Bashkë me organizmat e vendeve fqinje bëhet analizë e përbashkët risku për fenomenin e migracionit të paligjshëm në veçanti dhe për gjitha gamën e aktiviteteve të paligjshme në kufi. |
| 1.3 | Të hartohet lista e dokumenteve ligjore ndërkombëtare në lidhje me statusin e Shqipërisë dhe sigurimi i instrumenteve të nevojshme për t'i përditësuar dhe implementuar ato. | 1. Të identifikohet lista e dokumenteve ligjore të BE-së.<br>2. Të hartohet lista e tyre;<br>3. Të sigurohen materialet;<br>4. Të përkthehen;<br>5. Të punohen me personelin e kufirit. | 2014-2018 dhe në vazhdimësi | Kosto administrative | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>Partnerët ndërkombëtarë | PKM njeh dhe është trajnuar për njohjen e dokumenteve ligjore të BE-së ekzistuese dhe atyre që përditësohen.<br>PKM njeh institucionet e organizimit të BE-së.<br>Njeh organizimin dhe mënyrën e funksionimit të FRONTEX, EUROSUR dhe sistemeve të tjera për kufijtë e jashtëm. |
| **2** | **KUADRI INSTITUCIONAL** | | | | | |
| **2. OBJEKTIVI STRATEGJIK:**<br>Përsosja e strukturës në bashkëpunim me fqinjët dhe vendet e BE-së, me qëllim që të krijohen struktura fleksibël dhe të afta të bashkëpunojnë në kohë reale në interes të forcimit të sistemit të sigurisë kufitare. | | | | **Programi buxhetor:**<br>Buxheti i Shtetit dhe donatorë | | **Treguesi/t i rezultatit:**<br>Shkëmbimi i informacionit kryhet në nivel shumë të mirë |
| **Nr.** | **Nënobjektiv** | **Veprimet/masat për t'u ndërmarrë** | **Koha e realizimit** | **Burimet financiare të nevojshme** | **Institucionet përgjegjëse** | **Treguesit e monitorimit të masave** |
| 2.1 | Të synohet në bashkëpunim me fqinjët dhe praktikat e mira të BE-së, të punohet për krijimin e mekanizmave që mundësojnë aktivitete të përbashkëta. | 1. Identifikimi i nevojave dhe fushave që pengojnë bashkëpunimin;<br>2. Propozimi për krijimin e një mekanizmi gjithëpërfshirës për analizën e riskut ne | 2015-2018 | Kosto administrative | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>Partnerët ndërkombëtarë | Shkëmbimi i informacionit kryhet në nivel shumë të mirë, bëhet analizë e përbashkët e riskut, realizohen aktivitete të përbashkëta në kufi, dhe janë goditur më shumë persona/ grupe që kryejnë aktivitet të paligjshëm në kufirin shtetëror. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | rajon;<br>3. Hartimi i draftit të marrëveshjes;<br>4. Miratimi dhe zbatimi. | | | | |
| 2.3 | Të rritet bashkëpunimi ndërinstitucional dhe ndërkombëtar për menaxhimin e integruar të kufirit blu dhe të synohet kalimi nga një qendër kombëtare në një qendër rajonale koordinuese. | 1. Të ngrihet një grup i përbashkët me aktorët e monitorimit të kufirit blu për të hartuar propozimin;<br>2. Të përgatitet projekti dhe shkëmbehet me vendet e rajonit;<br>3. Të hartohet marrëveshja dhe ratifikohet;<br>4. Të zbatohet marrëveshja. | 2015-2018 | Në varësi të negociatave | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>MM(Roja Bregdetare)<br>QNOD<br>Partnerët ndërkombëtarë | Monitorimi i hapësirës detare realizohet në bashkëpunim me vendet e rajonit duke vënë në zbatim idenë e SEESUR, për monitorimin e hapësirës detare në vendet e Evropës Jugore dhe Juglindore.<br>Aktiviteti i paligjshëm nëpërmjet hapësirës detare identifikohet në kohë reale, reagimi është i shpejtë dhe i përbashkët.<br>Është ulur ndjeshëm numri i aktiviteteve të paligjshme nëpërmjet hapësirës detare. |
| **3** | **PROCEDURA** | | | | | |
| **3. OBJEKTIVI STRATEGJIK:**<br><br>Përditësimi i procedurave të PKM-së në përshtatje me procedurat e BE-së për kufijtë e jashtëm në drejtim të forcimit të bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndërkombëtar. | | | | **Programi buxhetor:**<br>Buxheti i Shtetit dhe donatorë | | **Treguesi/t i rezultatit:**<br>Procedurat Standarde të Punës së PKM-së janë plotësisht sipas standardeve të BE-së dhe zbatimi i tyre ka ndikuar në forcimin e bashkëpunimit me agjencitë homologe të vendeve të tjera. |
| **Nr.** | **Nënobjektiv** | **Veprimet/masat për t'u ndërmarrë** | **Koha e realizimit** | **Burimet financiare të nevojshme** | **Institucionet përgjegjëse** | **Treguesit e monitorimit të masave** |
| 3.1 | Të hartohet procedura që ka të bëjë me bashkëpunimin në përgjithësi dhe ajo për bashkëpunimin ndërkombëtar në veçanti. | 1. Të ngrihet grup pune për identifikimin e fushave të bashkëpunimit ; | 2016-2019 | Kosto administrative | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>Partnerët ndërkombëtarë | PKM bashkëpunon me partnerët ndërkombëtarë sipas procedurave të miratuara, të përputhura plotësisht me standardet e vendeve të BE dhe praktikat e mira. Shkëmbimi i |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | 2. Të hartohet projekt procedura për bashkëpunimin ndërkombëtar;<br>3. Të diskutohet me partnerët ndërkombëtarë;<br>4. Të miratohet dhe te zbatohet. | | | | informacionit bëhet në rrugët e miratuara dhe në afate të shpejta. Aktiviteti i kundërligjshëm identifikohet dhe shkëmbehet me vendet e tjera, duke siguruar veprime të përbashkëta për goditjen e tij. |
| 3.2 | Të hartohen procedura të përbashkëta për shkëmbimin e informacionit në QPBP, për operacionet dhe hetimet e përbashkëta. | 1. Të ngrihet grup pune për hartimin e procedurave për shkëmbimin e informacionit në QPBP, për operacionet dhe hetimet e përbashkëta;<br>2. Të diskutohet me partnerët ndërkombëtarë;<br>3. Të miratohet dhe të zbatohet. | 2014-2017 | Kosto administrative | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>Partnerët ndërkombëtarë | Qendrat e përbashkëta punojnë me procedura të miratuara bashkërisht nga palët.<br>Operacionet dhe hetimet e përbashkëta organizohen në bazë të procedurave të miratuara dhe të qarta.<br>Aktivitetet e përbashkëta kanë rritur reagimin e shërbimeve të kufirit për të goditur aktivitetin e kundërligjshëm. |
| 3.3 | Të hartohen procedura të përbashkëta për Qendrën Rajonale të Monitorimit të Hapësirës Detare në bashkëpunim palët pjesëmarrëse në të dhe me asistencën ndërkombëtare. | 1. Të ngrihet grup pune për hartimin e procedurave për Qendrën Rajonale të Monitorimit të Hapësirës Detare;<br>2. Të diskutohet me partnerët ndërkombëtarë;<br>3. Të miratohet dhe të zbatohet. | 2016-2019 | Ne varësi të negociatave | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>Partnerët ndërkombëtarë | Palët pjesëmarrëse në Qendrën Rajonale të Monitorimit të Hapësirës Detare, punojnë me procedura të qarta dhe të pranuara. Rezultatet nga aktiviteti i kësaj qendre janë të tilla sa kanë ndikuar në krijimin e një zinxhiri masash parandaluese për goditjen e aktivitetit të kundërligjshëm. Numri i aktiviteteve të kundërligjshme, që zhvillohen nëpërmjet hapësirës detare, që janë identifikuar/goditur është rritur, duke kryer operacione të përbashkëta nga palët pjesëmarrëse. |

| 4 BURIMET NJERËZORE Dhe TRAJNIMET | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **4. OBJEKTIVI STRATEGJIK:**<br><br>Përzgjedhja e personelit të jetë në funksion të realizimit të aktiviteteve të përbashkëta ndërkufitare dhe më gjerë, me qëllim realizimin e bashkëpunimit në aktivitetet e përbashkëta, si: operacione, patrullime, hetime dhe shkëmbim të informacionit. | | | | **Programi buxhetor:**<br>Buxheti i Shtetit dhe donatorë | | **Treguesi/t i rezultatit:**<br>Personeli që punon në PKM është përzgjedhur në funksion të realizimit të aktiviteteve të përbashkëta, me qëllim realizimin e bashkëpunimit në aktivitetet e përbashkëta si, operacione, patrullime dhe hetime të përbashkëta. |
| **Nr.** | **Nënobjektiv** | **Veprimet/masat për t'u ndërmarrë** | **Koha e realizimit** | **Burimet financiare të nevojshme** | **Institucionet përgjegjëse** | **Treguesit e monitorimit të masave** |
| 4.1 | Të arrihet që personeli që punon në PKM të njohë shumë mirë gjuhën angleze, por edhe gjuhën e shtetit fqinj nëse mundet. | Përzgjedhja e personelit bazuar në përshkrimin e detyrave dhe performancën e kandidatit. | Në vazhdimësi | Kosto administrative | MPB/PSHSH/PKM<br>Partnerët ndërkombëtarë | Personeli që punon në kufi ka të gjitha njohuritë profesionale dhe gjuhësore për të realizuar në praktikë një bashkëpunim real në kryerjen e operacioneve, patrullimeve, hetimeve dhe shkëmbimin e informacionit. |
| 4.2 | Të realizohen trajnime të përbashkëta me vendet fqinje dhe më gjerë në interes të harmonizimit të aktiviteteve të përbashkëta në interes të forcimit të sistemit të sigurisë kufitare dhe të bashkëpunimit ndërkufitar dhe ndërkombëtar në interes të sigurisë në kufi.<br>Trajnim për specializimin e punonjësve në fusha të ndryshme | 1. Identifikimi i fushave të trajnimit;<br>2. Përgatitja dhe miratimi i programeve të përbashkëta;<br>3. Bashkëpunimi me partnerët ndërkombëtarë për kurrikulat dhe zhvillimin e trajnimeve;<br>4. Zhvillimi dhe vlerësimi i trajnimeve;<br>5. Shkëmbim eksperiencash mes institucioneve tjera dhe të huaja. | Në vazhdimësi | 1470 lekë për person në ditë trajnimi.<br>5 145 000 lekë<br>Buxheti Shtetit dhe donatorë | MPB/PSHSH/PKM<br>Partnerët ndërkombëtarë<br>Personeli QNOD dhe institucionet që ofrojnë trajnimet në fusha të ndryshme | Personeli ka marrë njohuri të plota për legjislacionin komunitar, organizimin e BE, strukturat që kanë lidhje me kufijtë e jashtëm (FRONTEX), me sistemet e informacionit dhe të mbikëqyrjes së kufirit, nëpërmjet trajnimeve të vazhdueshme realizuar në bashkëpunim me partnerët ndërkombëtarë.<br>Rritje kapacitetesh profesionale për personelin e QNOD në teknologjinë e shkëmbimit të të dhënave dhe sigurinë e informacionit. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **5** | **KOMUNIKIMI DHE SHKËMBIMI I INFORMACIONIT DHE IT** | | | | | |
| **5. OBJEKTIVI STRATEGJIK:**<br><br>Shkëmbim i shpejtë i informacionit me agjencitë homologe në interes të zbatimit të misionit të tyre, nëpërmjet krijimit të qendrave të përbashkëta të bashkëpunimit policor dhe gjetjen e rrugëve të reja të bashkëpunimit me vendet e BE-së. | | | | **Programi buxhetor:**<br>Buxheti i Shtetit dhe donatorë | | **Treguesi/t i rezultatit:**<br>Shërbimet e PKM kanë mundësinë të marrin informacion në kohë reale nga sistemet e kontrollit kufitar dhe ato të mbikëqyrjes së hapësirës detare dhe kufirit të gjelbër. |
| **Nr.** | **Nënobjektiv** | **Veprimet/masat për t'u ndërmarrë** | **Koha e realizimit** | **Burimet financiare të nevojshme** | **Institucionet përgjegjëse** | **Treguesit e monitorimit të masave** |
| 5.1 | Të punohet për realizimin e shkëmbimit të informacionit me vendet e BE-së në kohë reale, duke gjetur mirëkuptimin e palëve për aksesim të sistemeve. | 1. Të krijohen grupe të përbashkëta punë për vlerësimin e sistemit tonë;<br>2. Përgatitjen e specifikimeve të shkëmbimit të informacionit;<br>3. Miratimi i projektit;<br>4. Zbatimi. | 2018-2019 | Kosto administrative | MPB/PSHSH/PKM/ DTI<br>Partnerët ndërkombëtarë | PKM sipas shembullit të rubrikës ASF2 të Interpol në bashkëpunim me DTI dhe partnerët ndërkombëtarë ka përgatitur kushtet për aksesimin dhe shkëmbimin e informacionit me databaze-n e BE-së. |
| 5.2 | Të punohet për shkëmbimin e informacionit në qendrat e përbashkëta të bashkëpunimit policor me vendet fqinje, duke përsosur formularin elektronik të kërkesës dhe përgjigjes për informacion. | Të përgatitet dhe miratohet projekti për shkëmbimin elektronik të kërkesës dhe përgjigjes për informacion. | 2016-2018 | Kosto administrative | MPB/PSHSH/PKM/ DTI<br>Partnerët ndërkombëtarë | Kërkesa dhe dhënia e përgjigjes për shkëmbimin e informacionit bëhet nëpërmjet formularëve elektronikë. Në bashkëpunim me DTI është krijuar një rubrikë e veçantë për këtë. |
| **6** | **INFRASTRUKTURA DHE PAJISJET** | | | | | |
| **6. OBJEKTIVI STRATEGJIK:**<br>Të krijohen sa më shumë PKK të përbashkëta dhe të synohet përdorimi i përbashkët i pajisjeve. | | | | **Programi buxhetor**<br>Buxheti i Shtetit dhe donatorë | | **Treguesi/t i rezultatit:**<br>Pikat e reja që janë hapur me vendet fqinje janë të përbashkëta, të dy palët punojnë bashkërisht me procedura të |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | | miratuara dhe pajisjet e dhëna në përdorim përdoren bashkërisht. |
| **Nr.** | **Nënobjektiv** | **Veprimet/masat për t'u ndërmarrë** | **Koha e realizimit** | **Burimet financiare të nevojshme** | **Institucionet përgjegjëse** | **Treguesit e monitorimit të masave** |
| 6.1 | Të punohet që marrëveshjet ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve fqinje për hapjen e PKK të reja të përcaktojnë që ato të jenë të përbashkëta. | 1. Të përgatiten marrëveshjet duke specifikuar krijimin e PKK të përbashkëta;<br>2. Negocimi me vendet fqinje;<br>3. Miratimi i marrëveshjeve;<br>4. Hartimi i protokolleve të zbatimit dhe procedurave të punës;<br>5. Hapja e PPKK;<br>6. Zbatimi në praktikë i marrëveshjes dhe protokollit. | Në vazhdimësi | Kosto administrative | MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>MF/SHDSH<br>Partnerët ndërkombëtarë | PKK që miratohen janë të përcaktuara në marrëveshje që do të jenë të përbashkëta. Ambientet janë të përbashkëta dhe pajisjet përdoren bashkërisht nga të dyja palët. |

SHËRBIMI DOGANOR SHQIPTAR

| **A. KUADRI LIGJOR RREGULLATOR** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **1. OBJEKTIVI STRATEGJIK:**<br>Të bashkëpunohet me strukturat e Delegacionit të BE-së, të Komisionit Evropian dhe të OBD për përafrimin e plotë të legjislacionit doganor me atë të vendeve anëtare të BE-së. | | | | **Programi buxhetor:**<br>Buxheti i Shtetit dhe donatorë | | **Treguesi/t i rezultatit:**<br>Ka baza ligjore që lejojnë bashkëpunimin doganor efikas me të gjitha vendet fqinje. |
| **Nr.** | **Nënobjektiv** | **Veprimet/masat për t'u ndërmarrë** | **Koha e realizimit** | **Burimet financiare të nevojshme** | **Institucionet përgjegjëse** | **Treguesit e monitorimit të masave** |
| 1.1 | Të parashikohet në ligjin e shërbimit doganor dispozita që mundësojnë doganat të bashkëpunojnë dhe të shkëmbejnë informacion (duke përfshirë të dhëna) me vendet fqinjë dhe partnerët ndërkombëtarë | 1. Vlerësimi i situatës aktuale dhe shtrirja e mundshme e bashkëpunimit me PKK e tjera;<br>2. Të përmirësohen marrëveshjet doganore ndërkombëtarë dhe ato ku BE-ja është palë;<br>3. Zhvendosja e marrëveshjeve përkatëse në legjislacionin kombëtar, nëse është e nevojshme. | 2014-2017 | Kosto administrative | MF/SHDSH<br>MD<br>MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>Partnerët ndërkombëtarë | Ekzistojnë marrëveshje për kontrolle të përbashkëta në PKK.<br>Marrëveshje/protokolle për asistencë reciproke me shërbimet doganore të vendeve të tjera dhe autoritete të huaja qeveritare për një bashkëpunim të qëndrueshëm.<br>Marrëveshje me BE-në dhe/ose vende të tjera për bashkëpunimin dhe dhënien e informacionit për të luftuar kontrabandën, mashtrimin tregtar dhe aktivitetin kriminal, dhe për të përmirësuar efikasitetin e shërbimeve doganore. Konventat, marrëveshjet dhe rekomandimet doganore ndërkombëtare në lidhje me kontrollin e kufirit dhe të brendshëm janë zhvendosur në legjislacioni kombëtar. |
| 1.2 | Krijimi i një liste të përditësuar të dokumenteve ligjore ndërkombëtare në lidhje me statusin e Shqipërisë dhe sigurimi i instrumenteve të nevojshme për t'i përditësuar dhe implementuar ato lehtësisht. | 1. Të identifikohen dokumentet ligjore të BE-së;<br>2. Të hartohet lista;<br>3. Të sigurohen materialet;<br>4. Të përkthehen;<br>5. Të punohen me personelin. | 2014-2018 dhe në vazhdimësi | | MF/SHDSH<br>MD<br>MIE<br>MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>Partnerët ndërkombëtarë | SHDSH njeh dhe është trajnuar për njohjen e dokumenteve ligjore të BE-së ekzistuese dhe atyre që përditësohen.<br>SHDSH njeh institucionet e organizimit të BE-së.<br>Njeh organizimin dhe mënyrën e funksionimit të FRONTEX, EUROSUR dhe sistemeve të tjera për kufijtë e jashtëm. |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **B. KUADRI INSTITUCIONAL** | | | | | | |
| **2. OBJEKTIVI STRATEGJIK:**<br>Të përmirësohet në vijimësi organizimi i SHDSH, në linjë me praktikat me të mira të vendeve anëtare të BE-së dhe rekomandimet përkatëse të OBD. | | | | **Programi buxhetor:**<br>Buxheti i Shtetit dhe donatorë | | **Treguesi/t i rezultatit:**<br>Ndryshimet strukturore të SHDSH, janë në linjë me ato të agjencive homologe të BE, me qëllim që të lehtësojnë shkëmbimin e informacionit. |
| **Nr.** | **Nënobjektiv** | **Veprimet/masat për t'u ndërmarrë** | **Koha e realizimit** | **Burimet financiare të nevojshme** | **Institucionet përgjegjëse** | **Treguesit e monitorimit të masave** |
| 2.1 | Të bëhet një studim për përsosjen e organizimit të SHDSH, në mënyrë që të jetë në përputhje të plotë me standardet e BE-së. | 1. Ngritja e grupit të punës për organizmin e SHDSH;<br>2. Identifikimi i mangësive dhe përgatitja e propozimeve;<br>3. Diskutimi me agjencitë e tjera;<br>4. Miratimi i ndryshimeve strukturore;<br>5. Zbatimi i ndryshimeve në strukture. | 2016-2017 | Kosto administrative | MF/SHDSH<br>MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>Partnerët ndërkombëtarë | Ndryshimet të strukture kanë ndikuar në fleksibilitetin dhe forcimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. |
| **C. PROCEDURA** | | | | | | |
| **3. OBJEKTIVI STRATEGJIK:**<br>Të vijojë përmirësimi dhe thjeshtimi i procedurave doganore, për t'u përafruar plotësisht me ato të vendeve anëtare të BE-së, me qëllim lehtësimin e tregtisë së ligjshme dhe shkëmbimeve tregtare, qarkullimin e udhëtarëve dhe rritjen e cilësisë së kontrolleve kufitare. | | | | **Programi buxhetor:**<br>Buxheti i Shtetit dhe donatorë | | **Treguesi/t i rezultatit:**<br>Procedurat e përmirësuara kanë sjelle një klimë më të mirë për qarkullimin e shtetasve dhe mallrave. Siguria kufitare është forcuar. |
| **Nr.** | **Nënobjektiv** | **Veprimet/masat për tu ndërmarrë** | **Koha e realizimit** | **Burimet financiare të nevojshme** | **Institucionet përgjegjëse** | **Treguesit e monitorimit të masave** |
| 3.1 | Të bëhet përmirësimi i procedurave të punës në SHDSH në përputhje të plotë me ato të vendeve anëtare. | 1. Krijimi i grupit të punës për hartimin e procedurave standarde; | 2016-2018 | Kosto administrative | MF/SHDSH<br>MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU | Procedurat e punës janë përmirësuar dhe thjeshtuar. Shkëmbimi i informacionit me agjencitë homologe të vendeve të tjera bëhet në bazë të procedurave të sakta dhe |

<table>
<tr><td></td><td></td><td>2. Të bëhet identifikimi i procedurave që duhet të përmirësohen dhe të përgatitet propozimi;<br>3. Të diskutohen me agjencitë;<br>4. Të miratohen procedurat;<br>5. Zbatimi.</td><td></td><td></td><td>Partnerët ndërkombëtarë</td><td>transparente.</td></tr>
<tr><td colspan="7">D. BURIMET NJERËZORE DHE TRAJNIMET</td></tr>
<tr><td colspan="4">4. OBJEKTIVI STRATEGJIK:<br><br>Të vijojë përmirësimi i procedurave të rekrutimit, promovimit dhe kualifikimit bazë e atij ekspert, bazuar në një strategji të burimeve njerëzore të ndërtuar mbi praktikat e mira të vendeve anëtare të BE-së.</td><td colspan="2">Programi buxhetor:<br>Buxheti i Shtetit dhe donatorë</td><td>Treguesi/t i rezultatit:<br>Personeli që punon në administratën doganore në të gjitha nivelet është i mirëtrajnuar për të realizuar detyrën e strukturës dhe i aftë të bashkëpunojë me agjencitë homologe të vendeve të tjera.</td></tr>
<tr><td>Nr.</td><td>Nënobjektiv</td><td>Veprimet/masat për t’u ndërmarrë</td><td>Koha e realizimit</td><td>Burimet financiare të nevojshme</td><td>Institucionet përgjegjëse</td><td>Treguesit e monitorimit të masave</td></tr>
<tr><td>4.1</td><td>Të realizohen operacione të përbashkëta me partnerët ndërkombëtarë për të luftuar mashtrimin dhe krimin e organizuar, si edhe të përdoren analiza të përbashkëta të rrezikut.</td><td>1. Pjesëmarrja e në operacionet e koordinuara të SECI, OLAF, OBD (duke përfshirë RILO ECE);<br>2. Të emërohet Koordinatori Kombëtar;<br>3. Të zhvillohen operacionet.</td><td>2016-2017</td><td>Kosto administrative</td><td>MF/SHDSH<br>MPB/PSHSH/PKM<br>MSH/SHSA/<br>MPBZHRAU/AKU<br>Partnerët ndërkombëtarë</td><td>Operacionet e përbashkëta realizohen në vazhdimësi dhe kanë forcuar luftën dhe goditjen aktivitetit të kundërligjshëm në fushën doganore.</td></tr>
</table>

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
